

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5568
E mërkurë, 5 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Hahni nuk e përjashton mundësinë e ndryshimit të kufijve

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

BISEDIMET KOSOVË - SERBI: TRI KËRKESA PËR T'U MBAJTUR PARASYSH NGA KOSOVA F. 8



Prof. Lisen BASHKURTI, *ambasador*

QEVERIA I JEP DREJTIM REFORMËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE F. 11



Besnik TAHIRI

EKONOMI


ÇMIMET E IMPORTIT SHËNUAN NGRITJE PËR 0.9 PËR QIND F. 9

KULTURË


RECENSION PËR LIBRIN E AUTORIT MR. SCI. HAMZ LLADROVCI ME TITULL: "ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE 1856-2018"

MATERIALET ARKIVORE TË ARKIVIT TË VJENËS, TË BUDAPESTIT, TË PARISIT, TË TIRANËS DHE TË BRUKSELIT, VLERA SHKENCORE F. 12

Prof. Dr. Muhamet MALA



UJËZA BEQIRI E PASIONUAR PAS FOTOMODELIZIMIT F. 15



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

FAQE 4-5

Përgjegjësinë për mospajtim rreth dialogut e kanë PDK-ja dhe LDK-ja

- Ekipi negociator i Qeverisë shpëton presidentin dhe eviton rrëzimin e Qeverisë

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se përgjegjësinë kryesore për arritjen e një gjuhe të përbashkët për fazën finale të dialogut me Serbinë e kanë PDK-ja dhe LDK-ja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re",

ai ka thënë se këto dy subjekte politike do të duhej ta gjejnë mënyrën e pajtimit rreth një platforme minimale të interesit kombëtar për periudhën e fazës finale të dialogut me Serbinë. Maliqi në këtë intervistë ka folur edhe

për ekipin negociator të propozuar nga Qeveria, duke e vlerësuar hap shumë të vonshëm të ekzekutivit. Sipas tij, ky ekip negociator e shpëton presidentin dhe eviton rrëzimin e Qeverisë Haradinaj

Opozita nuk do që të përfshihet në ekipin negociator të Qeverisë

FAQE 7

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në seancën e së martës ka paraqitur para deputetëve emrat e ekipit negociator të Qeverisë për bisedime me Serbinë, duke i bërë thirrje edhe opozitës të përfshihet në këtë ekip, por një gjë e tillë është refuzuar nga partitë opozitare. Ekipit negociator i kanë dhënë mbështetje partitë në pushtet



Njohësit e sigurisë: Dialogu s'ka ndikim për anëtarësim në Interpol

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bushati: Lufta ndaj terrorizmit nuk është e lehtë

TEL-AVIV, 4 SHTATOR - Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ditmir Bushati, në fjalën e tij në punimet e Konferencës së 18-të ndërkom-bëtare të luftës kundër terrorizmit, vuri theksin në domosdoshmërinë e një bashkëpunimi në luftën ndaj terrorizmit. "Lufta ndaj terrorizmit nuk është dhe nuk do të jetë e lehtë, por nuk ka alterna-

tivë dhe nuk duhet të ndihet e dekurajuar. Ashtu si rrjetet terroriste janë transnacionale, kështu duhet të jetë edhe bashkëpunimi ynë", tha Bushati.

Më tej Bushati prezantoi angazhimin dhe kontributin e Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit, duke vënë theksin në shpalosjen e nismave të reja që

lidhen me rolin e edukimit, harmoninë fetare, respektimin e të drejtave të njeriut e minoriteteve, vlerave të tolerancës ndaj diversitetit dhe për hartimin e zbatimit e politikave të posaçme strategjike, sociale, politike, ligjore, edukative dhe ekonomike. Gjatë vizitës së tij, Bushati zhvilloi disa takime bilaterale.



Kriza në Turqi mund ta ngadalësojë shtytjen e saj për ndikim në Ballkan

Analistët thonë se trazirat financiare të Turqisë mund t'i ngadalësojnë investimet e ardhshme turke në Serbi, Bosnjë, Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë, vende këto në të cilat Ankaraja gjendet në rivalitet të ndikimit së bashku me Bashkimin Evropian, Kinën dhe Rusinë

ANKARA, 4 SHTATOR - Në jug të Serbisë, një kompani turke e veturave është parë si shpëtimtare, pasi ka krijuar qindra vende pune dhe ka frymëzuar një jetë të re në rajonin e pazhvilluar dhe të shkatërruar nga luftërat e viteve të '90-ta. Por, me rënien dramatike të vlerës së monedhës turke gjatë këtij viti, si pasojë e hezitimit të investitorëve dhe mosmar-rëveshjeve diplomatike me Shtetet e Bashkuara, ekzistojnë shqetësime në Serbi dhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor se investimet e tilla mund të zbehen.

Analistët thonë se trazirat financiare të Turqisë mund t'i ngadalësojnë investimet e ardhshme turke në Serbi, Bosnjë, Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë, vende këto në të cilat Ankaraja gjendet në rivalitet të ndikimit së bashku me Bashkimin Evropian, Kinën dhe Rusinë. "Ne jemi të shqetësuar se kriza në Turqi nuk do të kalojë pa pasoja për ne", thotë ministri serb i Tregtisë, Rasim Lajiq, transmeton agjencia AP. Tregtia mes Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë ka shënuar rritje prej 430 milionë dollarësh në vitin 2002 në 3 miliardë dollarë gjatë vitit 2016,

shumë kjo nga e cila vetëm Serbia përfshinë një të tretën. Turqia bën pjesë në 10 partnerët kryesorë tregtarë të Serbisë, ndërsa sa i përket Kosovës, ajo është ndër tre partnerët kryesorë.

Udhëheqësit në Evropën Perëndimore janë të shqetësuar për zgjerimin e ndikimit autoritar në Ballkan të presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan. Vendet e Ballkanit Perëndimor formalisht dëshirojnë integrimin në Bashkimin Evropian, por kandidimi i tyre është vënë në pritje për shkak të problemeve të brendshme të BE-së, si Brexit, dhe pikërisht kjo situatë vlerësohet se e ka ekspozuar Ballkanin karshi ndikimit ekonomik dhe politik nga Turqia, Kina dhe Rusia.

Ballkani ka qenë nën pushtimin osman për 500 vjet, që do të thotë se ka lidhje kulturore me trashëgiminë myslimane në Kosovë dhe Bosnjë. Ekzistojnë mendime se vendet e Ballkanit Perëndimor, për presidentin Erdogan, janë mjaftueshëm të rëndësishme në aspektin gjeopolitik që Turqia të përpiqet t'i mbajë investimet dhe tregtinë ekzistuese.

Aleksandër Medjedoviq, një anëtar i Bordit të Këshillit të



Biznesit Turko-Serb, thotë se Turqia ka gjasa t'i mbajë investimet ekzistuese, por që ato mund të shtyhen. "Luhatjet në normat e monedhës kanë gjithnjë ndikim në ekonomi dhe tani po ndikojnë në ekonominë turke", tha Medjedoviq. Por, sipas tij, "Ballkani është një fushë strategjike për investitorët turq".

Në Bosnjën e dominuar nga myslimanët, investimet turke janë mjaft modeste, mirëpo ndikimi i saj politik ka shënuar rritje që nga lufta e përgjakshme atje në vitet e '90-ta. Organizatat humanitare turke

kanë rindërtuar ura dhe xhamitë e vjetra që datojnë nga koha osmane si dhe financuan në fushën e arsimit. Ato kanë shpenzuar rreth 300 milionë euro në projekte jofitimprurëse në Bosnjë. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan dëshmoi shkallën e ndikimit politik, kur në muajin maj mbajti një tubim parazgjedhor në Sarajevë, përderisa tubime të tilla u ndaluan në Gjermani dhe Austri.

Derisa Turqia është një investitore e madhe në Bosnjë, vitin e kaluar Ankaraja premtoi tre miliardë euro për financimin e

një autostrade që lidh Sarajevën dhe Beogradin. Medjedoviq thotë se Turqia e sheh Ballkanin, në veçanti Serbinë dhe Kroacinë, kryesisht si një "portë" për mallrat e saj drejt Bashkimit Evropian. Pra, përderisa ka pikëpyetje rreth investimeve të reja turke, menaxherja e kompanisë turke që ka investuar në jug të Serbisë, Fikret Aynibal, thotë se nuk ka asnjë vendim të kompanisë që përfaqëson për t'i ndaluar investimet në Serbi dhe rajon pasi planet për investime bazohen në periudha pesë apo dhjetëvjeçare.

Xhaferi: Nëse dështon referendumi, vendosin institucionet

SHKUP, 4 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, është i bindur se shumica e qytetarëve do ta mbështesin referendumin e 30 shtatorit, ndërsa i bëri thirrje opozitës të silltet me përgjegjshmëri. I pyetur se çfarë do të ndodhë

nëse nuk arrihet konsensusi i nevojshëm në referendum, Xhaferi u shpreh se, në rast dështimi, çështja do të kalojë në duart e institucioneve. "Në situatën që të mos ketë konsensus, nënkupton që qytetari abstenon nga e drejta të marrë

përgjegjësi vendimmarrëse dhe le hapësirë që institucionet që i ka zgjedhur ta vazhdojnë bartjen e përgjegjësisë në proceset e radhës, vijuese për këtë çështje, për të cilën ato në vazhdimësi japin përkrahje për proceset integruese. Këto janë udhërrëfimet

ku ne lëvizim dhe ku duhet të lëvizim të gjithë. Aspektet e interpretimeve akademike, profesionale, nuk i përjashtoj, por ato janë interpretime analitike të cilat nuk bartin përgjegjësi për asgjë", deklaroi Talat Xhaferi, kryetar i Kuvendit.



Qeveria e Kosovës vazhdon ta ketë prioritet anëtarësimin e vendit në organizata ndërkombëtare

Njohësit e sigurisë: Dialogu s'ka ndikim për anëtarësim në Interpol

Përveç zyrtarëve qeveritarë, edhe njohësit e çështjeve të sigurisë kanë bërë me dije se gjatë këtij viti shteti i Kosovës ka gjasa më të mira për t'u bërë pjesë e organizatës ndërkombëtare të sigurisë, Interpol. Ish-drejtori i përgjithshëm i policisë, Behar Selimi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në përgjithësi ka ndryshim të disponimit të shteteve të cilat kanë pasur rezerva që Kosova të bëhet pjesë e kësaj organizate. Ai ka theksuar se është në të mirë të sigurisë kombëtare dhe rajonale nëse Kosova anëtarësohet në Interpol. Selimi ka vlerësuar se procesi i dialogut nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol sepse, sipas tij, kjo më tepër është çështje e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Bejtush Gashi, ka thënë të martën se anëtarësimi i Kosovës në Interpol dhe organizata të tjera të sigurisë edhe më tutje mbetet prioritetin kryesor i tij dhe Qeverisë. Ai ka vlerësuar se ky anëtarësim mundëson dhënien e kontributit të shtetit të Kosovës në sigurinë rajonale dhe globale. "Anëtarësimi i Kosovës në organizata të sigurisë, sidomos anëtarësimi në Interpol, është prioritet kryesor imi, i cili do t'i mundësonte Kosovës të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe globale, në mënyrë që të jetë pjesë aktive në shkëmbimin e informacioneve për grupet kriminale", ka thënë ministri Gashi pas takimit me një delegacion nga Austria, i udhëhequr nga zëvendësministria e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Austrisë, Karoline Edtstadler.

Për procesin e anëtarësimin të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare të sigurisë ka folur edhe njohësi i çështjeve të sigurisë, Behar Selimi. Ai ka thënë të martën për gazetën "Epoka e re" se këtë vit gjasat janë më të mira që Kosova të bëhet pjesë e Interpolit. "Gjasat janë të mira dhe besoj se Kosova këtë vit do të pranohet në Interpol. Është

shtuar përpjekja e institucioneve tona, sidomos e politikës së jashtme, që të sigurohet përkrahja. Në përgjithësi ka ndryshim të disponimit të shteteve të cilat kanë pasur rezerva dhe tani e kanë të qartë se gatishmëria jonë për t'u bërë pjesë e Interpolit është në të mirë të Kosovës dhe të rajonit në përgjithësi. Prandaj po vlerësohet dhe po analizohet si një diçka që është në të mirën e sigurisë jo vetëm kombëtare, por edhe rajonale. Pra, janë rritur gjasat që sivejt të bëhemi pjesë e Interpolit", ka deklaruar Selimi. Ai ka vlerësuar se procesi i dialogut që po zhvillohet në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol sepse, sipas Selimit, anëtarësimi në këtë organizatë më tepër është çështje e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. "Unë nuk shoh ndikim të drejtpërdrejtë të procesit të dialogut meqë anëtarësimi i Kosovës në Interpol është më tepër çështje e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Pra, në një mënyrë është interes edhe i shteteve që nuk na kanë njohur që ne të jemi pjesë e parandalimit dhe luftimit të krimit me element ndërkombëtar", është shprehur ai, duke shtuar se nuk është me rëndësi jetike për të ardhmen e vendit.

"Nuk është më rëndësi jetike anëtarësimi ynë aty, prandaj nëse nuk kalojmë nuk pres të dëshpërohem dhe zhgënjehemi, përkundrazi le të dëshpërohen dhe zhgënjehen shtetet anëtare të organizatës sepse e kanë një shtet më pak në përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e krimit transnacional. Me gjithë rëndësinë e madhe që ka për shtetin tonë që të jemi pjesë e asaj organizate, po kaq e rëndësishme është edhe për shtetet anëtare të Interpolit që ne të jemi pjesë e Interpolit", ka theksuar Selimi.

Kurse sa i përket procesit të anëtarësimin në organizata të tjera të sigurisë, ai ka thënë se nuk pritet të ketë ndryshime dhe përparim, sidomos në Evropol. Megjithatë, Selimi ka thënë se pritet të avancohet roli i Kosovës në Evropol si dhe thellimi i bashkëpunimit në nivelin e operacioneve të përbashkëta policore me shtetet anëtare të saj. "Në Evropol pres që të thellohet bashkëpunimi operacional. Pra, nuk pres

ndryshime apo përparime në aspektin e anëtarësimin sepse është shumë larg anëtarësimin, por pres thellim të bashkëpunimit në nivelin e operacioneve të përbashkëta policore me shtetet anëtare të Evropolit për shkak se është në interes për vendet e Evropës Perëndimore dhe për shtetet e Evropës Juglindore ku Kosova dhe gjeopolitika e saj është domosdoshmërisht e pakapërcyeshme në këtë lloj bashkëpunimi operacional-policor. Prandaj pres të thellohet bashkëpunimi dhe avancimi i rolit të Kosovës në Evropol, por jo edhe hapa konkretë në drejtim të anëtarësimin në Evropol, meqë ajo duhet të ndodhë pas anëtarësimin tonë në BE e që është rrugë goxha e gjatë", është shprehur Selimi.

Ndërsa anëtari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Fatmir Xhelili, ka thënë

për gazetën "Epoka e re" se tashmë Kosova i ka plotësuar kushtet për t'u bërë pjesë e Interpolit. "Besoj se Kosova i plotëson kriteret teknike për të qenë pjesë e Interpolit, por janë kriteret politike, faktikisht është shtetësia e papranuar në Kombet e Bashkuara. Mirëpo lobimi është shumë pozitiv në kohët e fundit dhe shpresoj se kjo do të realizohet. Nuk kam dëshirë të dal me prononcime se kur do të ndodhë kjo saktësisht, por shpresoj se Kosova do të bëhet anëtare e Interpolit", ka deklaruar Xhelili, duke shtuar se më problematike mund të jetë procesi për anëtarësim në Evropol ku dialogu me Serbinë mund t'i determinojë gjërat. "Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare është zinxhiror. Edhe në Evropol çështja është problematike dhe besoj se bisedimet me Serbinë dhe përfundimi i tyre i determinojnë gjërat. Megjithatë, bisedimet pritet të shkojnë më shpejt sesa që i paramendojnë njerëzit", ka theksuar ai.

Segmenti i autostradës Zahaq - Pejë përfundon në fund të shtatorit

PEJË, 4 SHTATOR (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, i shoqëruar nga këshilltari i ministrit Pal Lekaj, Pjeter Ndou, të martën ka realizuar vizitë inspektuese në punimet në fazën finale të segmentit të autostradës Zahaq - Pejë, për të cilën kanë paralajmëruar përfundimin në

fund të shtatorit. Ai ka kërkuar nga kompania e kontraktuar punë kualitative dhe me ritëm dinamik. Kadriu ka inspektuar edhe punimet në rrugët lidhëse, të cilat janë duke u bërë me standarde të larta. Me këtë rast u kontrollua edhe temperatura e asfaltit e cila rezultoi brenda parametrevë të

përcaktuar. Kjo rrugë është duke u realizuar me tërë infrastrukturën përcjellëse si pahitë mbrojtëse, bankinat anësore, nënkallimet dhe rrethotullimet e parapara. Përfundimi i këtij aksi rrugor i jep fund zvarritjes së punëve nga qeverisja e kaluar dhe lehtëson qarkullimin e qytetarëve të Pejës dhe tërë vendit.



Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Përgjegjësinë për mospajtim rreth



- Ekipi negociator i Qeverisë shpëton presidentin dhe eviton rrëzimin e Qeverisë

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se përgjegjësinë kryesore për arritjen e një gjuhe të përbashkët për fazën finale të dialogut me Serbinë e kanë PDK-ja dhe LDK-ja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto dy subjekte politike do të duhej ta gjejnë mënyrën e pajtimit rreth një platforme minimale të interesit kombëtar për periudhën e fazës finale të dialogut me Serbinë. Maliqi në këtë intervistë ka folur edhe për ekipin negociator të propozuar nga Qeveria, duke e vlerësuar hap shumë të vonshëm të ekzekutivit. Sipas tij, ky ekip negociator e shpëton presidentin dhe eviton rrëzimin e Qeverisë Haradinaj

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka kritikuar pozitën dhe opozitën për qasjen e tyre ndaj procesit të dialogut me Serbinë. Ai ka deklaruar se përgjegjësinë më të madhe në këtë drejtim e kanë PDK-ja dhe LDK-ja, të cilat nuk po e gjejnë një gjuhë të përbashkët për këtë çështje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka deklaruar se këto dy subjekte politike do të duhej ta gjejnë mënyrën e pajtimit rreth një platforme minimale të interesit kombëtar që do të afatizohej

për disa muaj. "Mendoj se pjesën më të madhe të përgjegjësisë e kanë dy partitë kryesore, PDK-ja dhe LDK-ja, që as në këto çaste kritike nuk po e gjejnë mënyrën e pajtimit rreth një platforme minimale të interesit kombëtar që do të afatizohej për disa muaj, pra për periudhën e fazës finale të dialogut kur ka gjasa të arrihet marrëveshja politike me Serbinë", ka thënë Maliqi. Ai ka bërë me dije se në këtë pajtim të dy subjektet politike do të mund ta caktonin edhe datën e zgjedhjeve të parakohshme. "Me këtë pajtim të dy partive do të mund të caktohej edhe data e zgjed-

dialogut e kanë PDK-ja dhe LDK-ja

'molla e sherrit' dhe me hapësirë të kufizuar manovruese, por që ka mundur të jetë më kërkuese dhe fleksibile në propozimet e zgjidhjeve, ose që të mos e komplikojë edhe më shumë punën duke propozuar 'korigjimin' e kufirit", ka thënë Maliqi.

Ai ka folur edhe për ekipin negociator të Qeverisë, duke thënë se ky është një veprim i vonuar i ekzekutivit. Maliqi ka treguar edhe për punën që duhet ta bëjë ky ekip. "Ekipi do të duhej të ishte instancë permanente konsultuese gjatë dialogut që reprezenton Kuvendin dhe shoqërinë dhe siguron konsensus paraprak për propozimet kompromise që arrihen gjatë dialogut, por që definitivisht i vulos Kuvendi, ose aprovohen me referendum", është shprehur analisti Maliqi.

"Epoka e re": Z. Maliqi, pak ditë para takimit të radhës në mes të Thaçit dhe Vuçiqit, Qeveria e Kosovës i ka propozuar Kuvendit ekipin negociator. Si e keni parë këtë veprim të Qeverisë?

Maliqi: Bëhet fjalë për një veprim që vjen vonë, shumë vonë. Është bërë gati një vit që flitet për nevojën që të ketë ekip të unitetit, kurse kjo tani bëhet në shpejtësi, praktikisht kur koha është duke rrjedhur - shahistët i thonë cajtnot. Çka është edhe më keq, kjo po ndodh në rrethana konfuzive dhe konfrontimesh të brendshme politike, ku opozita me hamendje kërkon mënjanimin e presidentit nga dialogu pa e ditur nëse e ka votën e mjaftueshme në Kuvend, kurse koalicioni qeveritar edhe ai kthjellat në momentin e fundit dhe kërkon kundërseancën e Kuvendit për legjitimimin e një ekipi gjysmak për dialog që e shpëton presidentin, por edhe eviton rrëzimin e Qeverisë. Në momentin kur po zhvillojmë këtë bisedë sërish shtyhet seanca e Kuvendit për më vonë dhe nuk dimë se çka do të ndodhë sonte.

"Epoka e re": Me këtë ekip Qeveria do ta ndihmojë presidentin Thaçi apo do ta kufizojë atë në dialogun me Serbinë?

Maliqi: Ekipi do të duhej të ishte instancë permanente konsultuese gjatë dialogut që reprezenton Kuvendin dhe shoqërinë dhe siguron konsensus paraprak për propozimet kompromise që arrihen gjatë dialogut, por që definitivisht i vulos Kuvendi, ose aprovohen me referendum.

"Epoka e re": Opozita e ka kritikuar këtë veprim të Qeverisë duke e braktisur seancën parlamentare në të cilën pritej të votohej ekipi negociator. A është kjo rruga e duhur të cilën e ka zgjedhur opozita?

Maliqi: Çfarëdo që ndodh sonte dhe nesër, është e qartë se kemi të bëjmë me papërgjegjësinë dhe joseriozitetin e të dyja palëve, edhe të pozitës dhe të opozitës. Në të vërtetë, është edhe instanca e tretë, Presidenca, që ka qenë 'molla e sherrit' dhe me hapësirë të kufizuar manovruese, por që ka mundur të jetë më kërkuese

dhe fleksibile në propozimet e zgjidhjeve, ose që të mos e komplikojë edhe më shumë punën duke propozuar 'korigjimin' e kufirit.

"Epoka e re": Po ashtu, opozita ka ftuar një seancë tjetër, në të cilën pritet t'i kufizohet presidentit e drejta për të negociuar për kufij me Serbinë. Duke i parë këto qëndrime të subjekteve politike, e shihni të mundshme arrijen një konsensus kombëtar për këtë çështje?

Maliqi: Mendoj se pjesën më të madhe të përgjegjësisë e kanë dy partitë kryesore, PDK-ja dhe LDK-ja, që as në këto çaste

kritike nuk po e gjejnë mënyrën e pajtimit rreth një platforme minimale të interesit kombëtar që do të afatizohej për disa muaj, pra për periudhën e fazës finale të dialogut, kur ka gjasa që të arrihet marrëveshja politike me Serbinë. Me këtë pajtim të dy partive do të mund të caktohej edhe data e zgjedhjeve të parakohshme diku në pranverë të vitit 2019, kur edhe BE-ja i ka zgjedhjet. Zgjedhjet janë të domosdoshme në të dy rastet, edhe nëse arrihet marrëveshja me Serbinë, edhe nëse ajo dështon dhe Kosova bëhet sfidë edhe më e madhe për BE-në.

Hahni nuk e përjashton mundësinë e ndryshimit të kufijve

Prishtinë, 4 shtator - Komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, nuk e ka përjashtuar mundësinë e ndryshimit të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë, por ka thënë se zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis dy vendeve duhet të kontribuojë në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e rajonit. "Jam në favor të zgjidhjes së çdo konflikti dypalësh dhe çdo zgjidhje duhet të kontribuojë në një stabilitet më të gjerë në rajon dhe jo të jetë në koston e të tjerëve", ka thënë Hahn në

një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë".

I pyetur nëse ndryshimi i mundshëm i kufijve mund të ndikojë tek Bosnja, Maqedonia apo vendet e Partneritetit Lindor, Hahn tha se është herët të flitet për këtë çështje. "(Palët) po negociojnë ende. Le të themi, disa ide janë shfaqur. Mendoj se një marrëveshje ligjërish e obligueshme midis Serbisë dhe Kosovës duhet të përfshijë shumë elemente. Mendoj se të dyja palët janë tani të vetëdijshme. Nuk do të thosha për

shqetësimet ndërkombëtare, por për kufizimet dhe, brenda tyre, shumë zgjidhje janë të mundshme", ka thënë Hahn. Po sipas tij, do të ishte e dobishme që palët ta arrijnë marrëveshjen deri në verën e vitit të ardhshëm. Ideja për ndryshimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë është shpalosur nga presidentët e dy vendeve, Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiq, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tyre dhe ajo ka ngjallur reagime për dhe kundër.



hjeve të parakohshme, diku në pranverë të vitit 2019, kur edhe BE-ja i ka zgjedhjet. Zgjedhjet janë të domosdoshme në të dy rastet, edhe nëse arrihet marrëveshja me Serbinë, edhe nëse ajo dështon dhe Kosova bëhet sfidë edhe më e madhe për BE-në", është shprehur Maliqi.

Ai ka vlerësuar se çfarëdo që të ndodhë me këtë proces, përgjegjësinë do ta kenë pozita dhe opozita. "Çfarëdo që ndodh sonte dhe nesër, është e qartë se kemi të bëjmë me papërgjegjësinë dhe joseriozitetin e të dyja palëve, edhe të pozitës, edhe të opozitës. Në të vërtetë, është edhe instanca e tretë, Presidenca, që ka qenë


Eshtrat e heroit Ilir Konushevci nga nëntori do të prehen në Prishtinë

PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim Halit Konushevcin, babanë e heroit të Kosovës, Ilir Konushevci. Kryeministri Haradinaj ka thënë se në nëntor të këtij viti, që përkon me festën e flamurit, do

të bëhet rivarrimi i heroit të Kosovës Ilir Konushevci, në varrezat e dëshmorëve në Prishtinë, në pajtim edhe me vullnetin e familjes.

Eshtrat e Ilir Konushevci deri më tani preheshin në varrezat e Tiranës, ndërsa nga nëntori i këtij viti do të jenë në mesin e

dëshmorëve dhe bashkëluftëtarëve të tij në Prishtinë, në një ceremoni që organizohet nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Ilir Konushevci ishte një prej figurave të shquara dhe një prej prijësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Bëhet thirrje për kujdes të shtuar gjatë lëvizjes së nxënësve në rrugë



EPOKA ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Gjatë periudhës janar - korrik të këtij viti në Kosovë kanë ndodhur gjithsejtë 3 434 aksidente me lëndime, duke mbetur të lënduar 6 833 persona. Ndërsa më shumë se 5 000 aksidente trafiku përfunduan vetëm me dëme materiale. Nga kjo shifër e lartë e numrit të aksidenteve dhe të lënduarve në trafik, gjatë kësaj periudhe kanë vdekur 67 qytetarë si pasojë e aksidenteve në rrugë. Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e lartë në trafik, aksidentet e kësaj

vere, por edhe fillimin e vitit shkollor ku trafiku bëhet më i dendur dhe rrjedhimisht edhe më i pasigurt për fëmijët, sikurse vitin e kaluar, edhe këtë vit Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, së bashku me Kolegjin e Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli", Forumin e Kosovës për Siguri në Rrugë dhe Asociacionin Kosovar të Motorizimit AMRKS, u ka bërë thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trafik për shtimin e kujdesit gjatë lëvizjes në rrugë. "Kjo thirrje për rritjen e sigurisë në rrugë u drejtohet të gjithë ngasësve të mjeteve motorike që

të jenë vigjilentë dhe të veprojnë duke respektuar në plotësi rregullat dhe shenjat e trafikut. Në mjedise shkollash, të shtohet kujdesi në mënyrë që të rritet siguria për fëmijët gjatë rrugës nga shtëpia në shkollë dhe anasjellas. Nga fëmijët kërkohet kujdes dhe vëmendje e shtuar gjatë kalimit të rrugës dhe lëvizjes së tyre në grupe", është thënë në njoftimin për medie të këtyre institucioneve.

Meqenëse ende mungon edukimi i mirëfilltë i fëmijëve për sjellje të duhur në trafik, ekspertët e këtyre institucioneve në bazë të hulumtimeve të deritashme të

zhvilluara me nxënës në shkollat e vendit lidhur me sigurinë e lëvizjes të fëmijëve në rrugë, kanë dhënë disa udhëzime dhe rekomandime me masa konkrete për prindërit dhe fëmijët në prag të fillimit të vitit të ri shkollor. "Udhëzohen prindërit që gjithmonë t'i shoqërojnë fëmijët nën moshën 10-vjeçare nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjellas, prindërit dhe mësuesit duhet të sigurohen se fëmijët e tyre i njohin rregullat e lëvizjes të sigurt në rrugë dhe të sigurohen se ata i njohin shenjat e trafikut që u përkasin atyre, shoqërimi i fëmijëve nga shtëpia deri në shkollë

dhe anasjellas duhet të bëhet përdërisa prindërit të sigurohen se fëmijët e njohin mjaftueshëm rrugën dhe i praktikojnë në tërësi udhëzimet duke lëvizur të sigurt. Gjithashtu, prindërit dhe mësuesit duhet t'i udhëzojnë fëmijët ta përdorin të njëjtën rrugë çdo ditë dhe t'i shmangin shkurtetat dhe kryqëzimet e panevojshme, parkingjet etj. Udhëzohen prindërit të marrin nga mësuesit ose kujdestarët orarin e saktë të fillimit dhe mbarimit të mësimi dhe për çdo ditë ta monitorojnë kohën dhe sigurinë e lëvizjes së fëmijëve", është thënë në njoftimin për media.

Prej 199 kandidatëve, 153 prej tyre i plotësojnë kriteret për t'u rizgjedhur staf akademik në UP

EPOKA ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) ka publikuar analizën e konkursit për përzgjedhjen e personelit akademik mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës 2018.

Sipas kësaj analize, prej 199 kandidatëve të kandiduar për pozita në UP, të vlerësuar nga komisionet, vetëm 153 i plotësojnë kriteret për t'u rizgjedhur ose avancuar si staf akademik. Prej 200 kandidatëve, 53 kanë kandiduar për pozitën profesor i rregullt, 63 kanë kandiduar për

pozitën profesor i asocuar dhe 83 kanë kandiduar për pozitën profesor asistent. Sipas ORCA-s, prej 26 buletineve të shpallura nga UP-ja, kjo organizatë ka shqyrtuar 23. Prej këtyre 23 buletineve janë rekomanduar pozitivisht 200 kandidatë nga komisionet vlerësuese.



Opozita nuk do që të përfshihet në ekipin negociator të Qeverisë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në seancën e së martës ka paraqitur para deputetëve emrat e ekipit negociator të Qeverisë për bisedime me Serbinë, duke i bërë thirrje edhe opozitës që të përfshihet në këtë ekip, por një gjë e tillë është refuzuar nga partitë opozitare. Ekipit negociator i kanë dhënë mbështetje partitë në pushtet

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Të martën Kuvendi i Kosovës ishte mbledhur për t'i mbajtur dy seanca të jashtëzakonshme, një për votimin e ekipit negociator të Qeverisë për bisedimet me Serbinë, tjetër të thirrur nga LDK-ja për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, konkretisht idesë së presidentit për korrigjimin e kufirit me Serbinë.

Në seancën e parë mbajtur të martën, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka paraqitur para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ekipin negociator të Qeverisë të formuar dy ditë më parë. Haradinaj ka kërkuar mbështetjen e Kuvendit për ekipin e tij negociator, në të cilin ai vetë nuk bën pjesë. Ekipi negociator do të drejtohet nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ndërsa pjesë e tij do të jenë edhe Enver Hoxhaj, Behgjet Pacolli, Dardan Gashi, Mahir Jagzhillari dhe Avni Arifi.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se janë lënë vende të lira për këtë ekip edhe për partitë opozitare dhe shoqërinë civile, por asnjë nga ta nuk kanë pranuar të marrin pjesë në të. "Ata nuk po dëshmojnë se e kanë qëllimin për ta ruajtur territorin. Më shumë kam bërë punë unë se krejt opozita bashkë. Ata kanë mundur të vijnë sot dhe ta marrin hisen e vet në këtë proces. Jam në komunikim të vazhdueshëm me krejt spektrin politik në vend, edhe pse kjo formulë në pamje të parë mund t'u duket atyre jo e duhura. Atëherë cila është ajo? Pra, cila është formula me të cilën do të përfaqësohet Kosova?!", ka thënë Haradinaj. Ekipit negociator i kanë dhënë mbështetje partitë në pushtet. Seanca e jashtëzakonshme, e cila ishte thirrur nga kryeministri për votimin e ekipit negociator,

ka filluar në orën 9:00 dhe është shtyrë dy herë radhazi deri në orën 18:30, e cila edhe më tej nuk ka vazhduar, në mungesë të kuorumit, pasi opozita veçse kishte paralajmëruar se nuk do të marrë pjesë në këtë seancë.

Kryeministri Haradinaj, pas shtyrjes dy herë radhazi të seancës, ka thënë se mosprania e partive opozitare është e gabuar. "Tani e kemi të vështirë të vlerësojmë se si do të veprojmë. Në fakt, ishte pak gabim kjo mosardhja e opozitës në seancën paraprake. Votimi i delegacionit të Qeverisë dhe të Kosovës ku ishte i paraparë edhe roli i opozitës, ose edhe dhënia e mendimit për këtë delegacion, do ta hapte një dialog, pastaj që edhe pozita ta ketë mendimin e vet për rezolutën (e opozitës). Mosardhja në seancë na ka nxjerrë në pozitë të pafavorshme", ka thënë Haradinaj.

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë se ekipi negociator i Qeverisë do t'i përfaqësojë vetëm interesat shtetërore. Ai ka thënë se qëndrimi i Partisë Demokratike të Kosovës është se territori i vendit është i pandashëm dhe, si i tillë, marrëveshja që arrihet me Serbinë duhet gjithsesi të ratifikohet në



Kuvendin e Kosovës. "Ekipi negociator do t'i përfaqësojë interesat shtetërore. Territori i Kosovës është i pandashëm dhe ky është qëndrimi i PDK-së. Marrëveshja duhet të ratifikohet në të dy kuvendet. Beteja nuk është në Kuvendin e Kosovës. Beteja është Brukseli dhe Nju Jorku. Kjo nuk është betejë elektorale", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka shtuar se edhe gjatë kohës që PDK-ja ishte në opozitë, sjelljet e saj ishin konstruktive, duke përmendur që kjo parti mori pjesë në një proces të dialogut të udhëhequr nga ish-presidenti, Fatmir Sejdiu. "Në vitin 2006 kemi qenë në opozitë dhe në atë kohë Thaçi dhe ne kemi marrë pjesë në një proces të udhëhequr nga Fatmir Sejdiu. Tani shtrohet pyetja se kush i mbron interesat shtetërore?! Z. Thaçi ka mandat ligjor dhe kushtetues që ta udhëheqë politikën e jashtme, dhe dialogu është pjesë e politikës së jashtme. Ne

në këtë delegacion do të jemi unikë në mënyrën e përfaqësimit", ka thënë Hoxhaj.

LDK-ja dhe LV-ja: AAK-ja dhe Nisma dorëzohen përballë Thaçit

"Seanca e thirrur nga Qeveria është dorëzim i AAK-së dhe Nismës përballë presionit të PDK-së dhe Thaçit për prishje të koalicionit dhe shantazheve në ditët e fundit", kështu është thënë në një komunikatë për media nga grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Aty thuhet se "këto dy parti tash do ta luajnë lojën e z. Thaçi, duke nëpërkëmbur shtetin e Kosovës. Ekipi negociator, që nuk përfaqëson vullnetin e shumicës së qytetarëve shumicë të Kosovës, do t'i përligj në emër të Qeverisë marrëveshjet e fshehta të z. Thaçi me Serbinë".

LDK-ja, po ashtu, thotë se shteti i Kosovës po hynë në një fazë kritike të ekzistencës së vet për shkak të veprimeve të kastës udhëheqëse, siç vlerëson kjo parti, "vrastare për perspektivën e shtetit të Kosovës". "Për LDK-në, sovraniteti dhe integriteti i Kosovës është i panegociueshëm. LDK-ja nuk do të lejojë përdhosje të shtetit të Kosovës. LDK-ja do t'u prijë ndryshimeve që duhet të ndodhin së shpejti në Kosovë. LDK-ja nuk do të dorëzohet ndaj dhunës që po i bëhet shtetësisë së Kosovës", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje

e quajti të turpshme seancën e Kuvendit të Kosovës ku u diskutua për ekipin negociator në bisedime me Serbinë. "Të gjithë jemi dëshmitarë që në Kuvend ndodhi shfaqje e turpshme, përpjekja e presidentit për t'ia bashkangjitur vetes një ekip negociator. Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj rezistuan nja dy muaj ditë, kurse sot do ta quaj dorëzim të AAK-së dhe Nismës karshi PDK-së", ka thënë Konjufca, duke shtuar se nuk ka dyshim që kufijtë e Kosovës nuk do të hapen. "Kjo është ditë e pikëllueshme për Kosovën. Këta do të shkojnë vetëm për t'ia bërë agjendën Thaçit, jo për ta mbrojtur Kosovën", ka deklaruar Konjufca.

Visar Ymeri: Koalicioni po ndihmohet nga LDK-ja

Deputeti i PSD-së, Visar Ymeri, ka komentuar seancën e jashtëzakonshme të thirrur nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se kjo seancë po e shton rrezikun për Republikën e Kosovës dhe pamundëson që Kuvendi të jetë organi më i parë vendimmarrës për këtë proces. Ymeri ka thënë se ata të parët e kanë thirrur seancën e jashtëzakonshme për ta vënë në votim rezolutën e propozuar nga opozita e cila do t'i pamundësonte presidentit Thaçi që të diskutojë për kufijtë në dialogun me Serbinë. Ndërsa ai fajësoi LDK-në e cila, sipas tij, po e ndihmon nisjen e seancës së thirrur nga Haradinaj.

Hoti: Teuta Rugova po merr pjesë në seancë pa pëlqimin e LDK-së

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se pjesëmarrja në seancën e jashtëzakonshme të deputetes së kësaj partie, Teuta Rugova, është në kundërshtim me qëndrimin e LDK-së. "Pjesëmarrja e deputetes Teuta Rugova në seancën e sotme është në kundërshtim me qëndrimin e LDK-së, i cili është bërë publik para fillimit të seancës. Secili deputet i LDK-së duhet të kontribuojë në debatin ku përcaktohen qëndrimet e grupit parlamentar të LDK-së dhe ka obligim t'i respektojë ato qëndrime", ka thënë Hoti.

Vrasje në ndërtesën e AKI-së

Prishtinë, 4 shtator - Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI) ka njoftuar zyrtarisht për vrasjen që ka ndodhur të martën në ambientet e kësaj agjencie. Përmes një njoftimi për medie, AKI-ja ka njoftuar se një zyrtar i sigurimit të brendshëm ka shtënë mbi një

punonjës të bufësë. "Sot, më 4. 9. 2018, rreth orës 09:10, në objektin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ka ndodhur gjuajtje me armë zjarri, me ç'rast një zyrtar i sigurimit të brendshëm ka shtënë mbi një punonjës të bufësë. Viktima ka ndërru-

ar jetë në QKUK", thuhet në njoftimin e AKI-së. Gjithashtu, është bërë me dije se rasti nuk ka të bëjë me çështje që ndërlidhen me veprimtarinë e AKI-së. AKI-ja ka theksuar se me hetimin e këtij rasti po merret prokurori kompetent.



Bisedimet Kosovë - Serbi: Tri kërkesa për t'u mbajtur parasysh nga Kosova



Prof. Lisen BASHKURTI,
ambasador

Kosova dhe Serbia po hyjnë në fazën finale të normalizimit të marrëdhënieve. Ky normalizim do të realizohet nëpërmjet arritjes së një marrëveshje të gjerë dypalëshe me mbështetje dhe garanci ndërkombëtare. Të dyja palët duket të jenë të tendosura maksimalisht. Kjo tendosje është normale po të kemi parasysh se marrëveshja synon që të lërë pas një konflikt të gjatë dhe të komplikuar historik. Por tendosjen më të madhe e kanë sjellë idetë konfuze për 'ndryshim', 'korrigjim' apo 'shkëmbim territorial' midis dy vendeve. Këto ide nuk janë të reja dhe të panjohura, sikundër pasojat e tyre janë të vjetra, të rrezikshme dhe fare mirë të njohura.

Ideatorët publikë, presidentët e Serbisë dhe Kosovës, Vuçiq dhe Thaçi, por edhe ata që qëndrojnë prapa tyre, nisen nga interesa krejt të ndryshme. Vuçiqi me performancë 'moderne' dhe 'perëndimore' në thelb po mendon e vepron as më shumë e as me pak si një 'neo-Garashanin' i kohës sonë. Ai synon ta rikthejë 'Serbinë e madhe' duke përfshirë gjithë pakicat serbe brenda kufijve politikë të shtetit amë, pa marrë parasysh se me këtë mendim dhe qëndrim u rikthehet shteteve në linja etnike, pra në thelb konflikteve dhe luftërave historike. Doktrinat e shteteve etnikisht të pastra historikisht kanë dështuar, por ama pas luftërave tejet të përgjakshme dypalëshe, rajonale dhe botërore.

Në këtë lojë Vuçiqi nuk është vetëm, ai mendon e vepron konstitucionalisht dhe institucionalisht, politikisht dhe opinionalisht, kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht.

Thaçi në shpalosjet e shpeshta publike u paraqit konfuz, i paqëndrueshëm, improvizues dhe i pasigurt, çka do të thotë se nuk ka kurrfarë doktrine dhe as strategjie përpara vetes. Ai herë deklaroi 'korrigjim kufijsh', herë 'ndryshim kufijsh', herë 'shkëmbim terriroresh', herë

'përrjashtim të ndarjes së Kosovës', herë 'bashkim të Luginës së Preshevës me Kosovën', pra herë kështu e herë ashtu. Ky konfuzion, kjo paqëndrueshmëri, ky improvizim është shprehje e qartë dhe e plotë se Thaçi është i papërgatitur për t'u përballur me idetë që vetë hedh në tregun politik dhe publik. Thaçi ka hedhur idetë pa pasur të qarta konceptet prapa tyre, ka hyrë në këtë lojë politike e publike me Serbinë pa parashikuar skenarët e mundshme, ka hyrë në një skenar që nuk sheh se çfarë humb dhe çfarë fiton Kosova, ka rënë në një kurth me pasoja të paparashikueshme për veten, për Kosovën dhe mbarë Ballkanin. Në këtë grackë diplomatike Thaçi është vetëm, pa baza kushtetuese dhe pa mbështetje institucionale, politike dhe opinionale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Në 'duelin diplomatik' Kosovë - Serbi, Kosova është më e brishtë, më e papërgatitur, më e disfavorshme dhe më e kërcënuar. Në këtë disbalancë forcash negociatore, kushdo që të jetë përfaqësuesi i Kosovës, në tryezën e bisedimeve është e nevojshme të mbahen parasysh tri kërkesat e mëposhtme:

1. Kuadri kushtetues

Kushtetuta e Kosovës është themeli juridik i shtetit të Kosovës. Mbi atë bazë Kosova u bë shtet i pavarur e sovran, demokratik e multietnik, me integritet territorial dhe aftësi për të hyrë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kushtetuta e Kosovës u bazua në paketën e propozuar nga Marti Ahtisari në fund të vitit 2007. Ajo përmban tri parimet themelore negociuese të arritura nga Grupi i Kontaktit për Kosovën, që ishin 'Kosova nuk ndahet, Kosova nuk kthehet në statusin e përpara viti 1999, Kosova nuk bashkohet me shtet tjetër'. Gjithashtu, paketa e Ahtisarit dizajnonte një Kosovë demokratike dhe multietnike, duke synuar mënjanimin e 'shtetit etnik tradicional'. Në tërësinë vet Pakoja e Ahtisarit e shndërruar në Kushtetutë arriti të krijonte Kosovën e sotme, me paqe të qëndrueshme të brendshme dhe me kontribut paqësor në Ballkan.

Pakoja e Ahtisarit rezultoi me Kushtetutë të suksesshme.

Nëse sot Kosova përballet me sfida në marrëdhëniet me pakicat serbe kryesisht në veri dhe me Serbinë në tërësi, këto sfida burojnë kryekëput nga Beogradi, nga doktrinat nacionaliste serbe, nga Kushtetuta e Serbisë si dhe nga politikën e sotme të saj. Sikundër burojnë edhe nga aleatët e mëdhenj të Serbisë. Kushdo që të jetë negociator i Kosovës dhe kushdo që të përpilojë strategjinë negociuese të saj lypet të mbajë në themel Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Aty përcaktohen 'vijat e kuqe' përtej të cilave nuk mund të shkojë asnjë negociator dhe nuk mund të përpilohet asnjë strategji. Shkelja e kuadrit kushtetues në thelb sjell në mënyrë të pashmangshme dështimin e shtetit të Kosovës në tërësi. Kolonat kushtetuese janë akti publik i fuqisë, i qëndrueshmërisë, i funksionalitetit dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës.

2. Bashkëpunimi i brendshëm ndërinstitucional

Politikëbërja dhe vendimmarrja në politikën e jashtme të Kosovës janë atribut i një sërë institucioneve të parashikuara qartësisht në Kushtetutën e saj. Sistemi politik i Kosovës dhe i Serbisë ka ndryshime të rëndësishme edhe në këtë aspekt. Edhe statutet kushtetuese të presidentëve të të dy vendeve ndryshojnë. Presidenti i Serbisë zgjedhet direkt nga populli. Si i tillë ai është përfaqësues direkt i sovranit ashtu sikundër edhe Parlamenti i Serbisë. Presidenti i Serbisë, si përfaqësues i sovranit ka tagër legjitim më të gjerë dhe të fuqishëm të përfaqësimit të Serbisë edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndonëse, si në çdo sistem politik të tillë, parimi 'check and balance' e detyron edhe presidentin e Serbisë të gjejë bashkë vendimmarrje me Parlamentin e Serbisë, ku në fund të fundit ratifikohen të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të negociuara dhe të firmosura nga presidenti serb. Presidenti i Kosovës zgjedhet nga parlamenti, në opsionin ultima me shumicë të thjeshtë. Ky president nuk është përfaqësues direkt i sovranit. Sovraniteti në Kosovë bartet te Parlamenti i Kosovës. Kjo e bën Kosovën republikë parlamentare

të qartë. Presidenti i Kosovës nuk ka tagër legjitimiteti - sovranit, kompetencat e tij janë të kufizuara, të dobëta dhe të limituara në përfaqësimin ndërkombëtar të Kosovës. Në dimensionin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes në politikën e jashtme Kosova është ndërinstitucionale. Parlamenti dhe Komisioni i Politikës së Jashtme, Qeveria dhe Ministria e Punëve të Jashtme, presidenti dhe Gjykata Kushtetuese janë në tërësinë e tyre, në institucionet që përfshihen në politikëbërjen dhe në vendimmarrjen e politikës së jashtme të Kosovës. Kushdo qoftë negociatori i Kosovës dhe kushdo që ta përpilojë strategjinë e negociimit të saj lypet të konsiderojë këtë tërësi institucioneve politikëbërëse dhe vendimmarrëse në politikën e jashtme. Shpërfillja ose anashkalimi i ndërinstitucionalizimit prodhon politika jolegitime, jo të qëndrueshme dhe jo të zbatueshme. Shpërfillja dhe anashkalimi ndërinstitucional do ta fuste Kosovën në krizë të thellë politike që do gjeneronte pasoja edhe në marrëdhëniet me fqinjët dhe me mbarë Ballkanin.

3. Bashkëpunimi me partnerët strategjikë, politikë e ndërkombëtarë

Projekti i shtetit të Kosovës qysh në fillimin e tij është produkt i partneritetit strategjik ndërkombëtar. Në këtë partneritet strategjik ndërkombëtar kanë spikatur veçanërisht shtetet e Quintit, ShBA, Gjermania, Britania, Franca dhe Italia. Shqipëria është gjithashtu pjesë e këtij partneriteti politik strategjik për Kosovën, por me peshë të limituar ndërkombëtare. Këta partnerë strategjikë vulosën Republikën e Kosovës dhe njohjen ndërkombëtare të saj. Në këtë konstelacion partneriteti politik strategjik, kohët e fundit po lakohet edhe Bashkimi Evropian. Këtu ka një pasaktësi. Bashkimi Evropian, bazuar në Traktatin e tij, nuk ka një politikë të jashtme unike. Politika e jashtme e BE-së është atribut i shteteve anëtare individuale të saj. Ka aspekte që BE-ja arrin konsensus në politikën e jashtme, sikundër ka edhe aspekte ku shtetet anëtare vendosin mbi bazën e interesave të tyre individuale. Në qëndrimin ndaj shtetit të

Kosovës, Bashkimi Evropian nuk ka konsensus. Ka shtete që e kanë njohur Kosovën, sikundër ka edhe shtete që nuk e kanë njohur atë. Pra, ka shtete pro Kosovës, sikundër edhe pro Serbisë. Ndaj Kosovës Bashkimi Evropian si nivel organizate është i dyzuar në mënyrë kontradiktore. Për këtë arsye Bashkimi Evropian ka përcaktuar pozicionin 'neutral' ndaj statusit politik të Kosovës. Bashkimi Evropian i arrin negociatat teknike sepse kaq ka mandat. Bashkimi Evropian nuk merret fare me statusin politik final të Kosovës. Por, normalizimi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi është kryekëput çështje politike. Në këtë aspekt Bashkimi Evropian si nivel organizate është i përçarë, i dobët dhe për këtë arsye nuk është dhe nuk ka se si të jetë partner politik strategjik i Kosovës. Kjo nuk cenon aspak rëndësinë e Bashkimit Evropian për Kosovën në aspekte të tjera të bazuara në Traktatin e Lisbonës, siç janë fusha ekonomiko - tregtare, katër lëvizjet e lira, rendi e ligji, acquis communitaires dhe në bashkëpunimin ndërqeveritar në fusha politike, sigurie dhe diplomatike ku ka konsensus. Partnerët politikë dhe strategjikë të Republikës së Kosovës kanë qenë dhe mbeten ShBA, Gjermania, Britania, Franca, Italia dhe specifikisht Shqipëria. Shtetet e Quintit plus Shqipëria kanë mbajtur një qëndrim unik dhe në kontinuitet për Kosovën. Prandaj, konsultimi dhe bashkëpunimi me to është 'condicio sine qua non' për Kosovën në çdo fazë të saj për sot dhe për shumë kohë. Republika e Kosovës dhe partnerët politikë dhe strategjikë të Quintit dhe Shqipëria kanë një agjendë të përbashkët. Kosova është sukses i kësaj agjende. Kosova nuk mund të jetë dështim pikërisht për shkak të kësaj agjende. Kushdo që të jetë negociatori për Kosovën dhe kushdo që ta përpilojë strategjinë e saj negociuese lypet të jetë në konsultim dhe bashkëpunim permanent me shtetet e Quintit dhe specifikisht me Shqipërinë. Në këtë mënyrë Kosova siguron mbështetjen dhe garanton një marrëveshje të arsyeshme, të drejtë dhe të dobishme për vete dhe për mbarë rajonin. Në nivel ndërkombëtar Quinti dhe në nivel rajonal edhe Shqipëria janë mbështetja dhe garancia më e madhe për Kosovën dhe për mbarë Ballkanin.

Matoshi: Qytetarët nuk do të mbeten pa ujë, KRU t'i paguajë borxhet

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, kanë takuar të martën përfaqësuesit e Kompanive Regjionale të Ujësjetës "ARRU" dhe "SHUKOS", me ç'rast kanë diskutuar për çështjen e vazhdimet të lejeve ujore dhe obligimet financiare të KRU-ve ndaj Qeverisë. Në këtë takim është arritur edhe një marrëveshje në mes të MMPH-së dhe Kompanive Regjionale të Ujësjetës (KRU) për shlyerjen e borxhit të akumuluar prej vitit 2007-2017 nga këto kompani në vlerë mbi 1.5 milion euro. Matoshi gjatë këtij takimi ka thënë se çështja e furnizimit me ujë mbetet prioritet i MMPH-së, ndërsa ka theksuar domosdosh-

mërinë e pagesës së borxhit nga kompanitë regjionale të ujërave. "Çështja e furnizimit me ujë për qytetarët e Republikës së Kosovës mbetet prioritet i MMPH-së. Po ashtu, çështje e rëndësishme për ministrinë tonë mbetet edhe shlyerja e borxhit të akumuluar mbi 1.5 milion euro që kompanitë regjionale të ujërave kanë ndaj MMPH-së nga viti 2007-2017", ka thënë Matoshi.

Po gjatë këtij takimi është bërë me dije se kompanitë regjionale të ujërave mund të pajisen me leje ujore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vetëm atëherë kur përfundojnë pagesën prej 20 përqindësh të borxhit për vitin 2017.

Është bërë me dije se në rast të moszbatimit të kësaj marrëveshjeje mund t'u merret leja ujore këtyre kompanive dhe për pasojë edhe licenca e operimit nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Përfaqësuesit e



Kompanive Regjionale të Ujësjetës kanë shprehur pajtueshmërinë për të përfunduar në periodë pesëvjeçare. KRU t'i paguajë borxhet të akumuluar prej vitit 2007-2017 nga këto kompani në vlerë mbi 1.5 milion euro.

Çmimet e importit shënuan ngritje për 0.9 për qind

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë (TM2) 2018. Indeksi i tërësishtëm i çmimeve të importit në Kosovë u ngrë për 0.9 për qind në TM2 2018, krahasuar me TM1 2018. "Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: produktet minerale (6.8 për qind); druri dhe artikujt e drurit (4.2 për qind); lëkura dhe artikujt prej saj (3.1 për qind); mjetet e transportit (1.5 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt prej tyre (1.3 për qind); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (1.0 për qind); produktet e industrive kimike (0.7 për qind); instrumentet optike,



fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (0.6 për qind); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elek-

trike (0.4 për qind); dhe artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0.2 për qind)", është bërë me dije në njoftimin e

ASK-së.

Sipas ASK-së, ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: tekstili dhe artikujt e tekstit (-2.9 për qind); produktet bimore (-2.8 për qind); metalet bazë dhe artikujt prej tyre (-2.5 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (-2.5 për qind); këpucët (-0.9 për qind); vajrat ushqyese (-0.7 për qind); shtazët e gjalla dhe prodhimet prej tyre (-0.3 për qind); dhe letra dhe artikujt prej saj (-0.2 për qind). "Ndërkaq, krahasuar TM2 2018 me TM2 2017 çmimet e importit u ngrhën në një mesatare prej 2.4 përqindësh. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet minerale (15.8 për qind); metalet bazë dhe artikujt prej tyre (6.2 për qind); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (4.5 për qind); druri

dhe artikujt e drurit (3.7 për qind); mjetet e transportit (1.2 për qind); dhe tekstili dhe artikujt prej tij (0.9 për qind)", është thënë në njoftimin e ASK-së, duke u shtuar se ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: këpucët (-12.2 për qind); lëkura dhe artikujt e saj (-7.4 për qind); letra dhe artikujt e saj (-6.6 për qind); artikujt e ndryshëm të prodhuar (-4.5 për qind); instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore, si dhe mekanizmat e orës (-3.7 për qind); shtazët e gjalla dhe prodhimet e tyre (-1.8 për qind); prodhimet bimore (-1.7 për qind); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-1.6 për qind); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (-1.2 për qind); dhe vajrat ushqyese (-0.9 për qind).

Kosova dhe Shqipëria të përkushtuara për shtim të bashkëpunimit reciprok

PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Oemal Minxhozi, ka thënë se shifrat e bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri për këtë vit janë inkurajuese dhe ka rritje të shkëmbimeve tregtare. Gjatë një takimi me

kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ai ka theksuar se kjo tregon se potencialet e Kosovës për të eksportuar në pjesën tjetër të kombit janë shumë të mëdha. Gjatë takimit ambasadori Minxhozi dhe kreu i OEK-ut, Rukiqi, u paj-

tuan për disa iniciativa që mundësojnë rritjen e komunikimit mes dy komuniteteve të biznesit për të cilat duhet edhe vula e vendimmarrjes së dy qeverive përkatëse në kuptim të dhënies së përkrahjes dhe eliminimit të barrierave.



Nisin hetimet për aksidentin hekurudhor në Klinë

KLINË, 4 SHTATOR (ER) - Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike dhe Hekurudhore (KHAIA) pranë Zyrës së Kryeministrit, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur të martën ka marrë vendim për hapjen e hetimeve për aksidentin hekurudhor të datës 3 shtator në vijën hekurudhore Prishtinë - Pejë, në fshatin Dush të Komunës së Klinës, ku ishte i përfshirë treni i udhëtarëve nr. 761 me loko-

motivë 2620-016 dhe një automjet i tipit "Mercedes 190". Në këtë aksident kanë humbur jetën tre persona, njëri prej tyre fëmijë i moshës shtatëvjeçare.

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike dhe Hekurudhore (KHAIA) do të bëjë hetim të pavarur dhe do të dalë me një raport përfundimtar të cilin, sipas ligjit, do t'ia përcjellë Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.



Ministri Bytyqi vizitoi Gjimnazin 'Bedri Pejani' në Pejë

PEJË, 4 SHTATOR (ER) - Në kuadër të vizitave që po ua bënë shkollave të Kosovës, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka vizituar të martën Gjimnazin "Bedri Pejani" në Pejë. Në ditën e dytë të fillimit të vitit të ri shkollor, ministri Bytyqi fillimisht i ka uruar nxënësit dhe mësimitdhënësit e kësaj shkolle për një

vit të mbarë shkollor, vit ky për të cilin tha se do të jetë një vit i sukseseve në të gjitha shkollat e Kosovës.

Në bashkëbisedim me mësimitdhënësit e Gjimnazit, ministri Bytyqi u shpreh i kënaqur që gjendet në këtë shkollë, e cila është me traditë dhe ka nxjerrë gjenerata të tëra intelektualësh. Në vazhdim ministri Bytyqi ka theksuar se nga vizitat që po bënë nëpër komuna dhe nëpër shkolla, po vërehet një mobiliz-

im i përgjithshëm i autoriteteve komunale, mësimitdhënëseve, nxënëseve dhe prindërve. "Kjo na obligon të angazhohemi më shumë drejt përbushjes së synimeve për një arsim më cilësor", ka thënë ai. Duke folur për punën e mësimitdhënëseve, ministri Bytyqi ka theksuar se ata nuk janë vetëm të punësuar, por profesioni i mësimitdhënësit është i shenjtë dhe kërkon më shumë angazhim për të arritur suksese.



Nisin punimet për ndërtimin e shtatores së dëshmorit Sadri Vishaj

DEÇAN, 4 SHTATOR (ER) - Në fshatin Beleg të Komunës së Deçanit kanë filluar punimet për ndërtimin e shtatores së dëshmorit të kombit Sadri Vishaj.

Kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, ka thënë se kjo shtatore do të përurohet më 11 shtator, pikërisht në 20-vjetorin e rënies së dëshmorit Sadri

Vishaj. "Punimet do të vazhdojnë më tutje në ndërtimin e Kompleksit të Dëshmorëve në Lumbardh, Lloqan dhe Glllogjan", ka thënë Ramosaj.


Prokuroria Themelore në Gjilan vazhdon takimet e hapura me qytetarë

GJILAN, 4 SHTATOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan po vazhdon t'i mbajë takimet e hapura me qytetarë, të cilët shprehin interes të takohen me kryeprokurorin e kësaj prokurorie, Jetish Maloku. Prokuroria Themelore në Gjilan rregullisht çdo të hënë, nga ora 10:00-12:00, ka të caktuar takime të hapura me qytetarë, të cilat mbahen në zyrën e kryeprokurorit, ku të gjithë të interesuarit drejtpërdrejt nga kryeprokurori i kësaj prokurorie apo zëvendësi i tij kanë

mundësi të informohen për të gjitha çështjet, në të cilat shprehin interes. Ashtu si në ditët e tjera, edhe në takimet e së hënës kishte interesim të madh nga qytetarët të cilët kishin interes të takoheshin me kryeprokurorin e kësaj prokurorie. Vlen të theksohet se Prokuroria Themelore në Gjilan, si institucion i pavarur dhe i paanshëm, me qëllim që ta fuqizojë bashkëpunimin në mes të sistemit prokurorial dhe publikut, çdo javë vazhdon t'i zhvillojë takimet e hapura me qytetarët.



KU ËSHTË E VËRTETA



Jakup KRASNIQI

Si politika ashtu edhe opinioni publik në Kosovë është në terr informativ. Ky terr informativ u është shkaktuar nga njeriu i parë i vendit dhe mbështetësit e tij në Kosovë. Ajo që është e dukshme deri më tani, është kjo: Thaçi e Vuçiqi udhëhiqen nga një psikologji e filozofi mashtrimi ndaj opinioneve përkatëse. Në këtë rrafsh janë më shumë se të

njëjtë. Prej nga është ky identitet, nuk mund ta them se nuk është lëmë i studimit tim.

Qeveria vendosi ta formojë një komision për bisedime i cili duhet të miratohet në Kuvend. Mbase është mirë. Një gjë është e vërtetë: as koalicioni qeveritar nuk e di se për çka janë marrë vesh deri më tani presidenti i Kosovës me presidentin e Serbisë?! Ndoshta një mundësi për të mësuar se cila është marrëveshja Thaçi - Vuçiqi, është komisioni i Qeverisë së Kosovës. Ky komision duhet ta ketë për obligim t'i raportojë Kuvendit dhe ta njoftojë opinionin publik se për çfarë janë marrë vesh dy presidentët. Opinioni për të pasur një siguri më të madhe,

komisionit të Qeverisë duhet t'i bashkohet edhe opozita me përfaqësuesit e saj dhe në fund Kuvendi duhet të jetë ai që e miraton marrëveshjen finale.

Përndryshe, nëse i lihet kjo çështje një njeriu, as politika e as opinioni në Kosovë nuk do ta dinë se për çka po bëhet fjalë. Deri tani, prej që është hapur kjo temë, ne kemi arritur të mësojmë diçka nga presidenti Thaçi e diçka nga Vuçiqi e Daçiqi, por edhe po të bëhen bashkë këto që na ofron Thaçi dhe politika e lartë serbe, ne nuk mund ta kemi pasqyrën e plotë të asaj që ne presim ta shohim e ta dimë.

Ajo që e dimë deri më tani është kjo: Thaçi po e dëshiron Kosovën Lindore, por pa e cekur se çka do

të japë si kompensim për këtë. Ndërsa nga Vuçiqi e Daçiqi po e kuptojmë se po e dëshirojnë pjesën veriore të Kosovës. Ata po e përmendin: Jarinjën dhe Bërnjakun, në këtë fazë jo më shumë. Por, kjo nuk është e tëra. Nuk ka asnjë dyshim, hyrja në mes të këtij pazari nuk është për lavd për asnjë njeri. Fatmir Limaj ka marrë një përgjegjësi të madhe, njëkohësisht një rrezik të madh, kuptohet nëse këtë mundësi ia jep Kuvendi i Kosovës.

A ia vlen të rrezikohet?

Ndoshta ia vlen, por punë me rreziqe të shumta është. Bashkimi i përfaqësuesve të opozitës me komisionin qeveritar mund të jetë një siguresë më

e madhe për shumicën e njerëzve tanë. Kohë më parë ishte kërkesë e opozitës që këtë çështje ta marrë Qeveria. Mbase kishte të drejtë. Por kjo varet shumë se si kësaj çështje do t'i qaset nesër?

Opozita e ka një mundësi, sigurisht jo të artë, për t'u bërë pjesë e këtij problemi që duhet të zgjidhet. Opozita vetëm duke qenë pjesë e Komisionit Qeveritar e ka mundësinë për t'i ndihmuar pozitivisht këtij procesi. Procesit nuk mund t'i ndihmojmë nëse nuk bëhet platforma jonë për këto bisedime përfundimtare. Përndryshe, e humbet mundësinë për t'u informuar e për të ndikuar pozitivisht në këtë proces të ndërlikuar skajshmërisht!

Qeveria i jep drejtim reformës së administratës publike



Besnik TAHIRI

Pas një procesi të stërzgatur të nisur në vitin 2012, Qeveria miraton pakon e ligjeve të administratës publike. Pavarësisht prej vështirësive, ky proces hap një kapitull të ri për administratën shtetërore, duke vendosur qartë hierarkinë, strukturën dhe organizimin e administratës. Pavarësisht prej sfidave, procesi është detyrë e përmbushur në agjendën e reformave evropiane që i ka Kosova karshi integritit.

Është e qartë se pas pothuajse 20 vjet të rregullimit të pjesshëm në këtë fushë, në proces të jenë

shfaqur mangësi. Megjithatë, ka qenë e pakuptueshme që korpusi i administratës publike të funksionojë pa ligjet e saj bazike. Deri në këtë fazë administrata publike pothuajse është ndërtuar dhe ka funksionuar në mënyrë ad hoc, me mungesë qartësie për llogaridhënie dhe mbikëqyrje.

Tashmë kur ky proces ka marrë drejtim, pas mbështetjes së ekspertëve nga Bashkimi Evropian dhe pas një procesi të gjerë konsultues me aktorë, mund të konstatohet se Kosova ka vendosur themele të qëndrueshme të funksionimit të administratës publike.

Duhet theksuar se sikurse çdo proces reformues, edhe ky në administratën publike mund të ketë mangësitë e veta, por e rëndësishme është të vendosen korniza që në vazhdimësi japin mundësi për përmirësim. Procesi është bërë edhe më

sfidues duke pasur parasysh se kjo pako ka pasur shtrirje të gjerë. Përgjatë gjithë procesit është dashur të synohet funksionaliteti i administratës, njëkohësisht të ketë kujdes me korniza buxhetore.

Jam i vetëdijshëm se jo të gjitha kategoritë është arritur të akomodohen më së miri, me theks të veçantë korpusi i profesionistëve dhe shërbyesve që kanë detyra specifike e përgjegjësi horizontale. Megjithatë, mbetet detyrë që në proces të adresohen disa nga këto mangësi. Po ashtu, i tëri ky proces ka synuar barazinë në mes të pagës dhe detyrave. Pavarësisht prej eliminimit të mangësive, mbetet ende për t'u bërë në këtë proces.

Miratimi i kornizës ligjore është vetëm pjesa e parë e vështirë e procesit të reformës. Pjesa tjetër ndërlidhet me funksionalitetin e plotë të administratës për ta

kthyer atë në shërbim të qytetarit, zhvillimit dhe synimeve të përbashkëta integrale.

Përgjatë gjithë procesit, kam qenë i përkushtuar të siguroj mbështetje politike, konsensus, njëherësh ta pasqyroj domosdoshmërinë për këtë reformë. Është e qartë se një proces kaq i madh t'i ketë edhe skeptikët, por edhe kritikuesit. Për të dyja palët kam prezantuar jo vetëm nevojën por, para së gjithash, kushtin që kemi pasur përballë për ta bërë këtë reformë.

Para së gjithash, në nivel të koordinimit kam qenë një zë që kam mbrojtur dhe prezantuar punën e një korpusi të madh profesionistësh të përfshirë në proces që, pa mëdyshje, administrata publike ka shumë të tillë përbrenda. Por, administrata me domosdoshmëri duhet të rigjenerohet me energji, dije dhe profesionalizëm në vazhdimësi nga jashtë.

Pres që debati në komisionet funksionale t'i ndihmojë këtij procesi duke treguar kujdes për detyrat si vend dhe shoqëri, njëherësh respekt për punën e të gjithë atyre profesionistëve. Pres nga Kuvendi që diskursin partiak ta orientojë në debat profesional, duke dhënë kontribut në mënyrë që procesi të përmbillet me një reformë të thellë dhe serioze në këtë fushë. Administrata publike është motori i proceseve, pavarësisht prej platformave politike që do të qeverisin. Procesi i reformës nuk do të mund të bëhet i plotë pa transparencë, llogaridhënie dhe kontroll. Për këtë, roli i medias dhe shoqërisë civile është i domosdoshëm. Ndërkaq, synimi mund të vlerësohet se është arritur vetëm atëherë kur në plotësi t'i kemi kthyer meritokracinë konkursit publik dhe besimin e qytetarëve në administratë.

Rastet e dhunës në familje trajtohen me prioritet nga Prokuroria e Gjakovës

GJAKOVË, 4 SHTATOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjakovë vetëm gjatë muajit gusht 2018 ka pranuar 12 (dymbëdhjetë) raste të cilësuar si dhunë në familje, gjegjësisht për veprën penale nga neni 188/3 të KPK-së. Po ashtu, Prokuroria njofton se për të gjitha rastet është marrë aktvendim për fillim të hetimeve dhe u është caktuar paraburgimi 12 të pandehurve dhe ndaj tyre është duke u zhvilluar procedura hetimore. Gjithashtu, është marrë vendim për ekspertizë, ku

për secilin rast pritet të kthehet ekspertiza nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe të njëjtëve t'u ngrihet aktakuza. Prokuroria Themelore në Gjakovë ka njoftuar opinionin se i trajton me seriozitet të lartë të gjitha rastet, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë rasteve të dhunës në familje. Vlen të theksohet se në Prokurorinë Themelore të Gjakovës për rastet e dhunës në familje tash e dy vjet është i caktuar një prokuror i cili merret ekskluzivisht me këto raste.



Slovenia alarmohet nga milicia e armatosur e një politikani

Lubjanë, 4 shtator - Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, ka shprehur shqetësim për disa pamje të shpërndara në rrjetet sociale, në të cilat shihet një grup i armatosur me maska, që udhëhiqet nga një ish-kandidat presidencial, Andrej Sisko. Politikani Sisko ka thënë se grupi i tij është parë duke kryer stërvitje me qëllim të "ruajtjes së paqes dhe rregullit" nëse ka nevojë. Pahor ka thënë se nuk ka

vend për një grup të tillë në shtetin "e sigurt".

Ndërkohë, policia ka nisur hetim për këtë grup, i cili është parë me armë, mirëpo ka mohuar se i përket njësisë paramilitare.

Në disa pamje të publikuara në "Facebook" shihen rreth 70 persona të maskuar duke kryer një "betim solemn". Grupi drejtohet nga Sisko, i cili më herët ka qenë në burg për tentimvrasje. Ai pati

fituar 2.2 për qind të votave vitin e kaluar, kur ka garuar për president në shtetin e vogël evropian. Kabineti i presidentit Pahor ka thënë se "Slovenia është shtet i sigurt në të cilin nuk i lejohet asnjë personi të paaautorizuar të kujdeset në mënyrë të paligjshme për sigurinë e shtetit apo të kufijve". Sisko, në anën tjetër, ka pretenduar se grupi në fjalë nuk është duke bërë asgjë joligjore.



Liberalët e Evropës, të shqetësuar se kontinenti po i afrohet fundit të një epoke

Zgjedhja e librit "Të Përhënët: Si shkoi Evropa në luftë më 1914", nga kancelarja Merkel, flet për frikën e centristëve dhe të liberalëve, se rritja e nacionalizmit populist në Evropë, ushqyer nga një krizë migruese e pazgjidhshme, mund ta shënojë fundin e mundshëm të një epoke

BRUKSEL, 4 SHTATOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel po i këshillon ministrat e vet të lexojnë "Të Përhënët: Si shkoi Evropa në luftë më 1914", një libër që shqyrton shkaqet e Luftës së Parë Botërore dhe dështimet politike që kontribuuan në atë katastrofë.

1914-a është ndryshe nga viti 2018-a në shumë aspekte, por ajo që e shqetëson Merkelin dhe të tjerët të hedhin vështrimin nga e kaluara është se periudha para Luftës së Parë Botërore solli shfaqjen e politikës së njeriut të madh dhe kërcënimin e nacionalizmit, si dhe avancimin e projekteve nativiste nga udhëheqës të ndryshëm me përpjekjet e tyre për të bashkuar rajone të ndryshme apo për t'i nxitur valët e shovinizmit publik.

Stabiliteti gjeostrategjik dhe parashikueshmëria morën fund. Politikanët bënë gabime të mëdha në llogaritë e tyre. Autori i librit "The Sleepwalkers: How Europe Went to War in 1914", historiani Christopher Munro Clark, thotë: "Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, sistemi i stabilitetit dypolar global i ka hapur rrugën një grupimi më kompleks dhe më të paparashikueshëm të forcave, përfshirë rënien e perandorive

dhe ardhjeve në pushtet - një situatë që ka ngjashmëri me Evropën e vitit 1914".

Krahasimet me vitin 1914 janë përbuzur nga udhëheqësit nativistë të Evropës që akuzojnë kundërshtarët e tyre se janë alarmantë.

Zgjedhja e librit nga kancelarja Merkel flet për frikën e centristëve dhe të liberalëve se rritja e nacionalizmit populist në Evropë, ushqyer nga një krizë migruese e pazgjidhshme, mund ta shënojë fundin e mundshëm të një epoke.

Por centristët pro BE-së në kontinent, të udhëhequr nga Emmanuel Macron i Francës, po përpiqen ta rivendosin stabilitetin dhe parashikueshmërinë përballë rritjes së pasigurisë politike dhe të nativizmit. Në kundërshtim me ta është një bllok i udhëheqësve nativistë, me Matteo Salvini në Itali dhe në krye, i cili është i zënë me planet e betejës për zgjedhjet parlamentare të Bashkimit Evropian vitin e ardhshëm. Ata janë kthyer për të marrë këshilla nga ish-ndihmësi i presidentit Donald Trump, Steve Bannon.

Kampet kundërshtarë synojnë ta paraqesin garën e ardhshme elektorale si një moment përcaktues për bllokun shumëkombësh, të goditur nga



një krizë migrimi toksike dhe pabarazia ekonomike. Rusia ndërkohë ka ndihmuar në financimin e partive anti-BE-së në të dyja anët e spektrit politik. Në të njëjtën kohë, përtej Atlantikut, presidenti Trump po tregon gjithnjë e më shumë paqartësi për aleancën me bllokun që Uashingtoni ndihmoi të formohej.

Identiteti është në qendër të fushatës së ardhshme zgjedhore dhe përplasja e parë serioze do të vijë në qytetin austriak të Salzburgut, ku krerët e BE-së do të takohen më 19 shtator për një samit dyditor për të diskutuar edhe një herë Brexitin dhe trajtimin e krizës së imigrantëve si një bllok. Krerët nuk do të pajtohen për dy çështjet kryesore në agjendën zyrtare, duke reflektuar vizionet e tyre të kundërta për Evropën.

Në Salzburg, Macroni do t'i tregojë idetë e tij për reforma dhe rigjallërim të bllokut, duke

argumentuar për një integrim më të madh politik dhe ekonomik. Nacionalistët kërkojnë frenimin e integritit të mëtejshëm si pjesë e vizionit të tyre për ta ndryshuar kursin e bllokut për t'u bërë një grupim më i lirë i shteteve kombëtare, të cilat do të ishin më të lira nga Brukseli dhe më pak të detyruara nga traktatet e BE-së.

Kampionët kryesorë në luftën për kontroll mes liberalizmit dhe nacionalizmit u ndeshën javën e kaluar në një betejë fjalësh, duke dhënë një shije të garës elektorale që do të pasojë. Salvini dhe kryeministri hungarez Viktor Orban nisën një fushatë anti imigracionit, duke e pozicionuar Macronin si kundërshtarin e tyre kryesor. "Aktualisht ka dy kampe në Evropë dhe njëri drejtohet nga Macroni", tha Orban, i cili kërkoi të portretizonte udhëheqësin francez si pro-imigracionit duke argumentuar se ai është "lider i atyre partive që

mbështesin migracionin në Evropë dhe në anën tjetër jemi ne që duam të ndalojmë migrimin e paligjshëm".

Gjatë gjithë javës së kaluar, udhëheqësi francez u dha shtytje ideve të tij për reforma ambicioze, disa prej të cilave mbështeten nga Gjermania, për të nxitur integrimin e BE-së - një antidot siç e sheh ai ndaj asaj që ai e quan demokraci joliberalë të Orbanit dhe nacionalistëve të tjerë autokratë që sipas tij, po thjeshtojnë krizën e migrimit për të shtuar zemërimin nativist.

Macroni vuri në lojë udhëheqësit nacionalistë që pranojnë ndihmat e zhvillimit nga blloku ndërsa e përçmojnë BE-në. "Nuk do t'u jepja asnjë arsye nacionalistëve dhe atyre që përhapin fjalën e urrejtjes. Nëse duan të më shohin si kundërshtarin kryesor, kanë të drejtë", tha ai gjatë një udhëtimi në Kopenhagë.

Arif Alvi, president i ri i Pakistanit

ISLAMABAD, 4 SHTATOR - Ligjvënësit në Pakistan kanë zgjedhur Arif Alvi nga partia Tehrik-e Insaf si president të shtetit. Roli i presidentit në Pakistan është tejet ceremonial në të cilin udhëheqësi i shtetit zgjedhet në mënyrë indirekte nga ligjvënësit e Asamblesë Kombëtare, Senati

dhe katër asamblatë provinciale të shtetit.

Alvi është parashikuar se do të fitonte në votimin e 4 shtatorit, i cili vjen pas mbajtjes së zgjedhjeve kombëtare më 25 korrik dhe vetëm dy javë pasi Imran Khan është zgjedhur kryeministër i Pakistanit.

Alvi do të zëvendësojë Mamnoon Hussain, i cili pritet ta lirojë zyrën e presidentit më 8 shtator, pas kompletimit të mandatit të tij pesëvjeçar.

Pakistanit ka zvogëluar kompetencat e rolit të presidentit me anë të një amendamenti kushtetues në vitin 2010.



RECENSION PËR LIBRIN E AUTORIT *Mr. sci. HAMZ LLADROVCI ME TITULL: "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe 1856-2018"*

Materialet arkivore të Arkivit të Vjenës, të Budapestit, të Parisit, të Tiranës dhe të Brukselit, vlera shkencore



Prof. Dr. Muhamet MALA

Në hulumtimet e mirëfillta shkencore të radha janë ato publikime që në vete përmbajnë të kaluarën e cila në mënyrë paradoksale përputhet pothuajse ne tersi me aktualitetin. Rastet e tilla dëshmojnë faktin se disa ngjarje dhe disa aktor të historisë përkundër ndryshime kohore mbesin të njëjte ne veprime dhe qëndrime duke ndjekur skemat diplomatike të paracaktuar shumë kohë më parë.

Pikërisht libri i *Mr. sci. Hamz Lladrovci* i titulluar "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe 1856-2018" përshkruan, hulumton dhe publikon një qëndrim të tillë te pa ndryshuar në kohë dhe hapësirë të politikës rusomadhe ndaj shqiptarëve e cila me disa ndryshime te vogla mbeti anti shqiptare qe nga koha kur u krijua e deri me sot.

Autori *H.Lladrovci* duke e qenë ne dijeni te këtyre zhvillimeve historiko diplomatike me një guxim akademik por edhe me përkrahjen e Prof. dr. E. Zenelajt, ne librin "Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe 1856-2018" e plotëson një zbrazëtirë te mbetur studimore duke na ofruar një tablo të raporteve dhe qëndrimit te diplomacisë ruse ndaj shqiptareve qe nga Konferenca (Traktati) i Parisit i vitit 1856 kur Fuqitë Evropiane ndërhyjnë ushtarakisht kundër Rusisë së atëherëshme duke mbështetur Perandorinë e dobësuar Osmane si dhe duke e afruar atë ne te ashtuquajturin "Koncertin e Evropës" e deri ne vitin 2018 respektivisht deri ne ditët e sotme kur Rusia vazhdon ende te vepron nën hijen e pansllavizmit rus duke mbështetur planet shoviniste serbe ndaj çështjes shqiptare ne përgjithësi e ndaj çështjes së Kosovës në veçanti.

Duke lexuar publikimin e autorit *Hamez Lladrovci*, kuptojmë se në historinë diplomatike të Ballkanit zakonisht aleancat politike funksionuan duke u mbështetur ne interesat e përbashkëta politiko-etnike sllave, në afërsi religjioze ortodokse apo ne afërsi etnike dhe gjuhësore. Në te gjitha këto kombinime shqiptarët u lanë jashtë skemave diplomatike te fqinjëve hileqar ballkanik duke ja ndarë atyre rolin e viktimës, dhe sikur kjo mos te mjaftonte përkrahja anti shqiptare këtyrë qarqeve u erdhi me te madhe edhe nga aleati etnik, politik dhe fetar, nga Rusia.

Duke studiuar këto raporte te komplikuar gjeopolitike te Rusisë ndaj çështjes shqiptare nga libri i *z.Lladrovci* kuptojmë se qëndrimi i tillë i Rusisë ndaj çështjes shqiptare ishte i kondicionuar nga interesi gjeopolitik dhe diplomatik për te dalë ne "Detëra te nxehta" e që për ketë gjë domosdoshmërisht rrugët kalonin neper treva shqiptare. Në ketë rrugëtim antishqiptar pa dyshim qëndrimi rus ishte pro sllaveve ballkanik. Për ti sqaruar këto zhvillime dramatike te natyrës gjeopolitike dhe diplomatike autori *Lladrovci* në publikimin e tij ka kombinuar me sukses disa metoda hulumtimi dhe burime te proveniencave nga me te ndryshmet, si ato evropiane ashtu edhe kombëtare. Kësi soji autori përfundimet e veta shkencore i bie mbështetur ne bazë te analizës se dokumenteve duke përdorur metodën historike, krahasuese, statistikore si dhe ate deskriptive. Vlerën shkencore publikimit pa dyshim se ia shton edhe tryeza e gjere e materialit arkivor respektivisht dokumenteve te vjelura nga arkivat e Vjenës, Budapestit, Parisit, Tiranës dhe Brukselit. Me fjalë të tjera kritika historiografike, mbështetja dokumentare, publicistika shkencore dhe së fundi edhe vete mënyra e lehte dhe e kuptueshme e te shprehurit janë format e shprehjes përmes së cilave autori *Lladrovci* shpalos historinë e gjeopolitikës dhe diplomacisë ruse ndaj shqiptareve nga gjysma e dytë e shek. XIX e deri ne ditët e sotme. E gjithë kjo problematikë në librin e *z.Lladrovci* është e përmbledhur ne pesë kapituj qe ne vete ndjekin rendin kronologjik. Kapitulli i parë ne një formë informative i dedikohet historisë së shkurtër te popullit rus apo siç shprehet vetë autori paraqet një "Ekskurs" te shkurtër te historisë ruse duke sjell fakte interesante qe e bëjnë kurioz lexuesin dhe e përgatisin për te kuptuar me mire kapitujt ne vijim. Kapitulli i dytë i referohet kryesisht gjysmës së dytë te shek. XIX dhe ne vete ka kryesisht përmbajtje te natyrës diplomatike. Aty analizohet lindja dhe përhapja e idesë pan sllaviste respektivisht ideja e pansllavizmit ruso-sllav. Mbështetur ne dokumente burimore autori trajton prapaskenat e diplomacisë Austro-Hungareze dhe ruse ne raport m çështjen shqiptare duke përmendur marrëveshjen e fshehte te Reichstadit (1876), ku për here te parë shtrohet ne rrafshin diplomatik çështja shqiptare. Trajtimi i kësaj teme ne punim konsiston ne idenë se ne historiografinë kombëtare kjo konferencë është trajtuar jo ne mënyrë meritore andaj autori e rikthen edhe një here ne vendin e duhur duke ofruar te dhëna interesante lidhur me vendin e shqiptareve ne gjeopolitikën

evropiane te kohës. Punimi vazhdon me tutje duke trajtuar temat si Traktatin "fatal" te Shën Stefanit sa i përket trevave shqiptare për te vazhduar me tutje me Kongresin e Berlinit dhe takimet diplomatike te delegacionit Austro-Hungarez me carin e Rusisë *Nikollen e II* me 1897.

Kapitulli i terë ne kuptimin kohor i dedikohet fillimit të shek. XX dhe fillon me aleancat ballkanike qe i paraprinë Luftërave ballkanike dhe shpalljes se pavarësisë së Shqipërisë e l nuk u prit aspak mire nga qarët diplomatike ruse se pse ishte ne kundërshtim me aspiratat ekspansioniste te politikës rusomadhe. Kapitulli gjithashtu trajton edhe ndikimin e carizmit rus ne Ballkan ne kohën e Luftës së Parë Botërore si dhe rolin e Presidentit amerikan *Wilson*, qe kishte filluar te paraqitej ne skenën diplomatike te Evropës e që sa do pak do te balanconte

erdhi deri te ndërprerja përfundimtare e këtyrë raporteve si dhe dalja e Shqipërisë socialiste nga Pakti i Warshaves me 1968.

Kapitulli i peste dhe i fundit i dedikohet kryesisht çështjes se Kosove shikuar nga prizmi i politikës Ruse dhe qëndrimin e saj ndaj ndërhyrjes se NATO-së dhe pavarësisë së Kosovës. Pa dyshim se rendësi ne vete ne ketë kapitull paraqesin temat qe elaborojnë qëndrimin e Federatës Ruse ndaj pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimit te saj ne Organizatat ndërkombëtare. Autori duke u mbështetur ne qëndrimet aktuale te politikës ruse ndaj Kosovës me te drejte ne personalitetin e presidentit rus *Vladimir Putin* e sheh vazhduesin e politikës Pan sllaviste dhe mbështetësin kryesor te politikës shoviniste të Serbisë. Njëkohësisht autori ne një politike te tillë anakroniste te Rusisë ndaj Kosovës me te drejt e sheh rrezikimin e paqes ndërkombëtare dhe rikthimin e dhunës dhe luftërave te fund shekullit te kaluar. Ne fund libri përmban shqyrtimet kritik e përfundimtare te cilat autori i nxjerr logjikshëm nga trajtimet tematike dhe te cilat janë konkluzione te drejta mbështetur me përmbajtje burimore pa prejudikime dhe paragjykime qe zakonisht janë pjese përbërës e shkrimeve sllave ndaj çështjes shqiptare.

Me te drejte nga libri mund te konkludohet se me gjithë dëshirën e mirë dhe përpjekjet e bëra për te bashkëpunuar më popujt fqinje për pavarësimin politik dhe çlirim kombëtar, shqiptarët nuk hasen ne mirëkuptim apo nuk gjeten aleat të mirëfilltë në fqinjët e tyre dhe për ketë arsye një pjese te mire te fajit e barte edhe politika nxitëse dhe ekspansioniste rusomadhe e cila i frymëzonte dhe ndihmonte shtet fqinje sllave te Ballkanit kundër shqiptarëve, njësoj siç vepron edhe sot me rastin e ndihmës qe i ofron Serbisë ne destruktivitetin e saj ne raport me Kosovën. Shpesh here politika rusomadhe ndaj shqiptareve është e maskuar me terminologji fetare e kulturore e qe për qellim ka pasur dhe vazhdon te ketë, ta ndihmoje Serbinë qe te shkëput territore te caktuar nga Republika e Kosovës.

Sipas projekteve te hartuara ne vazhdimësi, politika agresive serbomadhe dhe rusomadhe është përpjekur më parë dhe aktualisht të "provon" se Kosova kishte qenë gjatë historisë "shpirt", "qendër" e "djep" i shtetit serb dhe trevë e banuar pothuaj ekskluzivisht nga serbët deri ne fund të shekullit XVII dhe në fillim të shekullit XVIII. Mbi këto konkludime politike qe pa dyshim se bien ndesh me realitetin historik dhe burimet relevante u ndërdua politika ekspansioniste serbe dhe ruse ndaj tokave shqiptare e cila ne punimin ne fjalë demaskohet mbështetur ne vlerat

burimore duke u marrë me analizën kritike të konceptit pan sllav nga gjithë dimensionet si ai fetar kulturor, etnik, politik e ekonomik.

Shikuar nga aspekti gjuhësor dhe metodik libri " Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe 1856-2018 " është i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme dhe të kuptueshme për të gjithë dhe një herit është një paraqitje reale shumë objektive e mbështetur në dëshmi e dokumente të shkruara madje është i argumentuar dhe begatur me dokumente te pa publikuara deri me tani te nxjerra nga arkivat evropiane. Lënda studimore ne libër, është shtruar në mënyrë specifike, dhe është trajtuar në formë integrale dhe të lidhur me lëmitë e diplomacisë historisë, gjeopolitikës madje edhe filozofisë pan sllaviste dhe te drejtës ndërkombëtare.

Është meritore fakti se në këtë libër dëshmohet se politika rusomadhe ndaj shqiptarëve nuk ishte e rastit dhe e hartuar ne mënyrë individuale. Ajo ishte konsistente ne kohe dhe hapësirë ishte institucionale dhe qëllimi kryesor i saj ishte dhe vazhdon te jetë dominimi politik, ekonomik e ushtarak i shtetit serb në Ballkanin Perëndimor e rrjedhimisht edhe i Rusisë.

Duke e marrë parasysh faktin se e gjithë lënda e përfshirë në këtë libër më gjithë përbërësit e saj paraqet një kontribut plotësisht origjinal, pasi që në këtë fushë komplekse kërkimore autori ka studiuar dokumentet të pa publikuara, literaturën relevante dhe shtypin kohës. Gjithashtu përdorimi i drejtë i metodologjisë me teknika shkencore bashkëkohore, i kanë mundësuar autorit për të arritur në përfundimeve të qëndrueshme. Punimi po ashtu është i shkruar me një gjuhe te pastër dhe te qarte që autori e plotëson me paraqitjen figurative duke e kompletuar tekstin dhe duke e bere me te kuptueshëm dhe me te afërt me lexuesin. Mbështetur ne këto vlerësime tona, konsiderojmë se autori ka arritur një ndërmarrje shkencore mbresëlënëse dhe me caqe të larta akademike.

Mendoje se publikime i paraqitur ne gjuhen shqipe në një te ardhme, gjithsesi do te duhej te përkthehej dhe te prezantohej edhe ne gjuhe te huaja ne mënyrë qe çështjet e komplikuar te gjeopolitikës ruse ndaj Ballkanit dhe shqiptarëve ti kuptojnë edhe te tjerët. Ky projekt ne gjuhe te huaja mund dhe duhet t'i shërbeje prezantimit sa ma real të historisë sonë para opinionit botëror për të fituar mbështetjen e botës së qytetëruar që ta përfillin popullin tonë në rrugën e integriteteve si njërin ndër popujt më të vjetër të Ballkanit dhe të Evropës.



drejtëpeshimin e prishur politik ne Ballkan dhe ne Evropë dhe do te imponohej si aktor i ri ne skenën diplomatike te botes.

Është me interes te veçantë veçmas nga sensi kritik i historiografisë trajtimi qe autori ia bene çajes se politikës se Rusisë socialiste ndaj vendeve Ballkanike si dhe raporteve te qeverise demokratike te Fan Nolit lidhur me Rusinë cariste. Pa dyshim se lidhur me këto zhvillime historiografia moniste shqiptare kishte shkruara nga këndvështrimin ideologjik andaj autori mundohet qe te jetë sa me real ne trajtimin e këtyrë ngjarjeve jashtë klisheve ideologjike e politike te së kaluarës.

Gjithsesi duke ndjekur ne tersi rendin kronologjik autori ne kapitullin e katërt trajton kohen e qeverisjes se komunisteve ne Shqipëri dhe raporteve te tyre me Bashkimin Sovjetik. Ky kapitull pa dyshim se përmban ne vete disa sytha me vlera shkencore ku trajtohen problemet e natyrës politike, ushtarake, ekonomike e kulturore qe Shqipëria e Enver Hoxhës pati me Bashkimin Sovjetik nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e deri me 1961, kur edhe

E rrallë

Muzikanti i pazakontë me gota qelqi

Muzikanti Jamey Turner zgjodhi një rrugë të pazakontë karriere, duke prodhuar tinguj muzikorë nga gotat e qelqit të mbushura me ujë. Ai rrëshqet me mjeshtëri mollëzat e

gishtërinjve mbi buzët e gotave, duke krijuar një sërë notash muzikore. Korrespondentja e "Zërit të Amerikës", Deborah Block, ka shkuar në Aleksandria të



shtetit Virxhinia ku mjeshtri i pazakontë i muzikës tërheq shumë turistë me tingujt që krijon.

BARSOLETA E DITËS



- Kamerier, më sill një take-tuke, të lutem!
- Më fal zotëri, por në lokalin tonë nuk lejohet pirja e duhanit.
- S'do të pi duhan, por do të ha fara.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D


I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Një fushë me luledielli në një fermë në Portel të Portugalisë. /Reuters/

Në ora 18:20

"FUTURE WORLD" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

E jashtëzakonshme

Aeroplani ikonë 'kthehet në jetë'

Lockheed Super Constellation është një avion i bukur, një model klasik i ShBA-së nga vitet 1950 me kthesa të lëmuara dhe helika të fuqishme. Por edhe pse 'Super Connie' është lënë të kalbet në një fushë me baltë në Azinë Juglindore për 25 vjet, ky nuk është fundi i tregimit. I ekspozuar ndaj diellit tropikal dhe shiut në një cep të Aeroportit Ndërkombëtar të Manilas, ky aeroplan i hijshëm dhe i bukur ishte i destinuar për



skrap. Autoritetet e aeroportit në Filipine vendosën ta vënë Super Connie në ankand dhe ai mori vëmendjen e Qantas Founders Museum, i drejtuar nga Qantas Foundation Memorial.




DASHI

Jeni duke punuar për të ardhmen tuaj dhe po e mendoni mjaft seriozisht mundësinë për të lëvizur diku tjetër.



DEMI

Në ambientin e punës duhet të krijoni kushte optimale për veten tuaj dhe për harmoninë midis kolegëve. Mos i vini re gjërat e vogla dhe pa rëndësi.



BINJAKËT

Keni kaluar limitet me një person që ka besuar tek ju. Nëse sot doni të rregulloni raportet, pala tjetër nuk ka aspak të njëjtin mendim.



GAFORRJA

Sot nuk keni pse tregoheni sipërfaqësor me problemet tuaja. Duhet të shihni në detaje shenjat që ju jepen për të kuptuar se ku keni gabuar.



LUANI

Sot jeni shumë të zënë me punë dhe për këtë arsye do t'i lini pas dore njerëzit tuaj të dashur. Çastet e humbura nuk ju kthehen më pas.



VIRGJËRËSHA

Edhe pse nga të tjerët kërkon shumë përkushtim kundrejt jush, ju vetë nuk jeni i gatshëm ta bëni këtë gjë për personat e afërt.



PESHORJA

Po kuptoni që personat që qëndrojnë pranë jush kanë interesa të tjera sesa miqësi reale. Do të filloni të mbani distanca dhe të tregoheni arrogant.



AKREPI

Duhet të krijoni përshtypje të pavarur nga të tjerët për persona të caktuar sot. Jeni paragjykses dhe kjo gjë do t'ju prishë punë personalisht.



SHIGJETARI

Dëshira dhe pasioni që kishit për një person të caktuar është shuar. Ju desh pak kohë derisa ta kuptoni, por tashmë jeni të qartë.



BRICJAPI

Ata që ju duan nuk kërkojnë asgjë tjetër përveçse lumturinë tuaj. Duke mos e kuptuar këtë gjë do të lëndoni pa masë një mik të afërt.



UJORI

Jeni më të hapur me ata që sapo i njihni sesa me personat afër jush. Keni frikë mos kërkojnë diçka që s'mund ta realizoni.



PESHQIT

Ka persona në jetën tuaj të përditshme që po ju bezdisin dhe me të cilët e dini mjaft mirë që nuk mund të ndërmerrni asgjë të përbashkët.

Ujëza Beqiri e pasionuar pas fotomodelizimit



PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER)- Ujëza Beqiri është nga Prishtina, ka lindur më 14 dhjetor në vitin 2014. Është nxënëse e klasës së katërt në shkollën "Xhemail Mustafa" në Prishtinë.

Ujëza ka qenë në shkollën e

aktrimin në "IS STAR" që drejtohet nga aktorja Teuta Krasniqi, pastaj në balet, si dhe valltare në Shoqërinë Kulturore Artistike "Bajram Curri" te të vegjlit, ku është shpërblyer edhe me mirënjohje.

Momentalisht vazhdon kursin

e gjuhës angleze "Oxford" si dhe në "Vija Models" është manekene dhe fotomodele.

Ujëza është një vajzë e zgjuar, e bukur dhe me shumë stil.

Ajo hapat e parë i ka filluar në "Vija Models", dhe thotë se e do fotomodelizimin dhe synon që

të vazhdojë në këtë fushë edhe pse e vogël në moshë. "E dua fotomodelizimin, e bëjë me shumë dashuri. Besoj se jam e prirë për këtë fushë", ka thënë ajo për gazetën "Epoka e re".

Ujëza thotë se në këtë dëshirë e ka përkrahjen edhe të

prindërve.

Ajo në faqen e saj në "Facebook" poston fotografi të saja, të realizuara në vende të ndryshme në Kosovë.

Ujëza Beqiri shpreson se një ditë do të ngjitet lartë drejt suksesit të modës.



Kosova propozon filmin 'Martesa' për OSCARS

PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Filmi "Martesa", me skenar dhe regji nga Blerta Zeqiri, fitues i dy çmimeve në Festivalin e Filmit në Talin, është propozimi zyrtar i Kosovës për kategorinë "Filmi më i mirë i huaj" në OSCARS.

"Martesa" flet për një trekëndësh dashurie pranë dhe gjatë një martese. Në rolet kryesore të filmit janë Alban Ukaj, Adriana Matoshi dhe Genc

Salihu.

Kryesuesi i komisionit përzgjedhës, Isa Qosja, u shpreh: "Filmi i propozuar është një tregim ndryshe nga ato që jemi mësuar apo detyruar t'i shohim tek ne, përmban një strukturë disa shtresore dramaturgjike, aktorët i gjallojnë fatet e tyre në mënyrë të natyrshme dhe me mjaft emocione. Regjisura është gati e pavërejtur dhe kjo i jep

këtij filmi rrjedhshmëri në perceptim të fabulës dhe përjetimit".

Filmi "Martesa" është mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës, është prodhim i kompanisë "Beze" me producent Keka Kreshnik Berisha. Përveç QKK-së, "Martesa" u përkrah edhe nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë e Shqipërisë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

AMERICA DE CALI - JAGUARES COR.

1

KASHIMA - FRONTALE KAWAS.

1

BURIRAM UNITED - CHIANGRAI

1

Kosova vazhdon përgatitjet për Azerbajxhanin dhe Ishujt Farore

Futbollistët e Kosovës, nën drejtimin e trajnerit Bernard Challandes, i kanë zhvilluar dy përgatitjet e radhës të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Futbollistët janë të kënaqur që tash do ta kenë mundësinë të luajnë në Kosovë, kurse presin fitore në dy ndeshjet e radhës në Ligën e Kombeve

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll është duke i vazhduar përgatitjet për dy ndeshjet në Ligën e Kombeve ndaj Azerbajxhanit më 7 shtator dhe më 10 shtator ndaj Ishujve Faroe. Djelmoshat e Kosovës nën drejtimin e trajnerit Bernard Challandes të martën i kanë zhvilluar dy seancat e radhës stërvitore. Kapiteni Samir Ujkani është optimist se Kosova mund të shënojë fitore në të dyja ndeshjet, kurse ka treguar se është një kënaqësi për futbollistët që t'i zhvillojnë seancat stërvitore

në stadiumin "Fadil Vokrri". "Është kënaqësi të stërvitesh në stadiumin 'Fadil Vokrri', ndërsa po e ndiejmë madhështinë e tij këtu që aq shumë dëshiron të luanim. E vështirë pa të, por ne do të luajmë e do të angazhohemi maksimalisht për të dhe për gjithë Kosovën. Atmosfera në mesin tonë është mjaft e mirë dhe ne besojmë shumë se do të kemi rezultate të favorshme. Kemi bërë një stërvitje në një nivel shumë të mirë. Kushtet janë shumë të mira pasi që fusha po na lejon për t'i bërë ushtrimet maksimale", ka thënë Ujkani. Ndërsa ylli i skuadrës së Werder Bremenit, Milot Rashica, ka bërë

thënë se përgatitjet me Kosovën po shkojnë mirë, kurse lëndimi i vogël i pësuar në skuadrën gjermane nuk është serioz. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë. E kam pasur një lëndim, po nuk është shumë serioz. Jemi duke bërë gjërat e nevojshme dhe besoj se çdo gjë do të jetë në rregull", ka thënë Rashica, i cili shihet

si ndër armët më të forta në Përfaqësuesen e Kosovës. Përgatitjet në Prishtinë dhe zhvillimin e lojërave si vendës i ka mirëpritur Hekuran Kryeziu, i cili beson se gjithçka do të shkojë në mënyrën më të mirë në dy ndeshjet e radhës. "Fusha është shumë e mirë. Janë këto gjëra që ne moti kemi dëshiruar si lojtarë

dhe si përfaqësues. Nuk do të ketë më udhëtime si më herët dhe shpresojmë se çdo gjë do të shkojë ashtu siç duhet", ka deklaruar Kryeziu.

Përfaqësueses që drejtohet nga zvicerani Bernard Challandes të martën i janë bashkuar edhe Edon Zhegrova, Herolind Shala dhe Mërgim Vojvodva.

Haradinaj: Kosova përfaqësohet më së miri në arenën ndërkombëtare përmes sportit



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, priti në takim delegacionin e Aleancës Globale për Integritetin e Sportit (SIGA), të kryesuar nga drejtori ekzekutiv Emmanuel de Medeiros, të cilët po qëndrojnë në Prishtinë, në kuadër të Forumit të IV-t të Aleancës Globale për Integritetin në Sport (SIGA), e cila punimet do t'i zhvillojë më 4 dhe 5 shtator në Prishtinë. Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës mbështet sportistët në çdo garë rajonale

dhe botërore, duke i vlerësuar ata ambasadorët më të mirë të paqes, të cilët po e lartësojnë emrin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Po ashtu, kryeministri Haradinaj theksoi faktin se sportistët kosovarë kanë shënuar histori duke na bërë krenarë me ngritjen e flamurit të Kosovës në Lojërat Olimpikë dhe gara të ndryshme ndërkombëtare, në të njëjtën kohë duke i sjellë Kosovës medalje. Sipas kryeministrit, Qeveria ka ndërmarrë hapa konkretë për krijimin e kushteve më të mira për sportistët përmes

investimeve në infrastrukturën sportive. Në takim u bisedua edhe për përgatitjet për Forumin e IV të Aleancës Globale për Integritetin në Sport (SIGA), i cili do të mbahet në Prishtinë, që temë kryesore do t'i ketë praktikën më të mira të integritetit në sport dhe integritetit financiar për sportin e pastër, për standardet universale të SIGA-s, të cilat e shtojnë sportin drejt një epoke të re. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës të kryesuar nga kryetari i KOK-ut, Besim Hasani.

Balaj: Izraeli e ka parë forcën tonë

TIRANË, 4 SHTATOR - Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Bekim Balaj, ka thënë se Izraeli e njeh mirë forcën e kombëtares kuqezi. "Jemi përballur me Izraelin. Edhe ai nuk flet me siguri, pasi e ka parë forcën tonë. Të gjitha ekipet duan vendin e parë. Edhe Skocia. Për ne është me rëndësi

të harmonizohemi. Mungesa e Sadikut dhe e Roshit dihet dhe uroj të kthehen sa më shpejt", ka thënë Balaj. "Miqësoret ishin për ta parë skuadrën, ku u panë lojtarë të rinj. Rezultatet nuk ishin të mira, por trajneri ka bërë zgjedhje të tjera. Janë kthyer lojtarët me përvojë. E njohim lojën e njëri-

tjetrit dhe mund të them se jemi gati për dy ndeshjet e radhës. Kemi bërë lojëra të mira përpara. Nuk duhemi gjykuar nga ato dy ndeshje miqësore. Është momenti për ta parë fytyrën e vërtetë dhe këto dy ndeshje janë prova e vërtetë", ka deklaruar sulmuesi Akhmat Groznit.



Ronaldo, bindshëm më i paguari në Serinë A

Torino, 4 shtator - Afrimi i Cristiano Ronaldos i riktheu shkëlqimin e munguar Serisë A. Ylli portugez është pa dyshim edhe lojtari më i paguar me një diferencë shumë më të madhe se futbollistët e tjerë. Paga vjetore e CR7 shkon plot 31 mil-

ionë euro, sa trefishi i Gonzalo Higuainit që mban edhe vendin e dytë. "Gazzetta dello Sport" ka bërë publike edhe listën e me 20 pagat më të larta të të lojtarëve në Serinë A. Në total fatura e të gjitha pagave shkon 1.1 miliard euro. Lojtarët më të

paguar në Serinë A (neto): Cristiano Ronaldo (31 milionë euro), Gonzalo Higuain (9,5), Paolo Dybala (7), Miralem Pjaniq (6,5), Douglas Costa (6), Gianluigi Donnarumma (6), Leonardo Bonucci (5,5), Emre Can (5), Lorenzo Insigne (4,6),

Mauro Icardi (4,5), Radja Nainggolan (4,5), Edin Dzeko (4,5), Ivan Perisic (4), Sami Khedira (4), Mario Mandzukic (4), Giorgio Chiellini (4), Blaise Matuidi (4), Juan Cuadrado (4), Wojciech Szczesny (4), Dries Mertens (4).



Bunjaki, afër marrëveshjes me Rizesporin

Prishtinë, 4 shtator - Ish-përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Albert Bunjaku, është duke biseduar për kalim te skuadra turke Rizespor, e cila këtë edicion është ngritur në elitën e futbollit turk. "Agjenti im është në kontakt me Rizesporin dhe këtë mund ta konfirmoj. Kam njohuri të thella për ligën turke, duke kuptuar se ne kishim Kombëtaren e Turqisë në kualifikime dhe unë për dy vjet rregullisht kam udhëtuar drejt Turqisë për t'i përcjellë lojtarët tanë, por edhe kam vizituar klubet turke ku sot kam shumë miq atje siç janë Fatih Terim, Kemal Ozdes e shumë tjerë. Pra, është një kampionat shumë i fortë dhe jo rastësisht është në top 10 të botës", ka thënë Bunjaki për "Telegrafin". "Kam përcjellë ndeshjet e Rizesporit, madje edhe isha në stadium, pasi kisha Vedat Muriqin aty. Rizespor



është një klub interesant me traditë të thellë dhe njerëzit atje e duan shumë futbollin. Jam shumë i sigurt se Rizespori për një kohë të shkurtër mund të luajë në Evropë, pse jo. Kam kërkesa të mëdha për vetën dhe lojtarët që do të ushtrroj.

Përderisa ne besojmë gjithçka mund të realizohet. Për mua është me rëndësi që atje tani është edhe Ujkani që në realitet ishte kapiteni im në Përfaqësuesen e Kosovës, por ka edhe shumë lojtarë të mirë", ka deklaruar Bunjaki.

Ginobili: Nga basketbolli u largova për shkak të familjes



SAN ANTONIO, 4 SHTATOR - Pas 16 vjetësh karrierë në NBA, ku fitoi edhe katër tituj kampionë me skuadrën e San Antonio Spurs, basketbollisti argjentinas Manu Ginobili u tërhoq, një vendim që befasozi disi fansat e 41-vjeçarit. Në një deklaratë për mediet, Ginobili shpjegoi arsyen që e detyroi të merre këtë vendim. "U tërhoqa pasi dëshiroja të qëndroja më shumë me familjen time. Gruaja dhe fëmi-

jët më shtynë ta merrja këtë vendim. Me bashkëshorten time në krah kam përjetuar me emocione këto 23 vjet karrierë në basketboll. Ajo është kujdesur për fëmijët, por tani është koha të kaloj më shumë kohë me të dhe miqtë e mi në Argjentinë", ka thënë Ginobili. Më tej, basketbollisti argjentinas, që hoqi dorë nga 2.5 milionë dollarë nga kontrata që skadonte verën e 2019-s, shton: "Luajta sezonin e

kaluar në NBA sikur të ishte sezoni im i fundit, edhe pse nuk e dija se do të tërhiqesha. Por vendimi erdhi pas pushimeve me familjen dhe mendoj se ishte vendimi i duhur dhe i drejtë për t'u marrë. Nuk ishte e lehtë për ta shkruar vendimin e tërheqjes nga sporti, por jam i përgatitur për të ardhmen, edhe pse nuk e di se si do të jetojë pa basketbollin. Por, do të jem i shoqëruar nga familja ime".

SHKURT

Duro, trajner i KF Kamza

Bledar Devolli do të zëvendësohet në bankinën e Kamzës nga Klodian Duro, i cili në të shkuarën ka drejtuar skuadrën e Kukësit, duke fituar edhe Kupën e Shqipërisë, që ishte trofeu i parë në histori për verilindorët. "Klubi bën të ditur pajtimin me trajnerin Klodian Duro. Prezantimi zyrtar do të zhvillohet të mërkurën në orën 17:00 në ambientet e klubit", thuhet në njoftimin e KF Kamza.

Eliminohet Maria Sharapova

Befasi e madhe te femrat në US Open ishte eliminimi i Maria Sharapovas nga spanjollja Suarez Navarro 6-4, 6-3. Sharapova nuk ishte në ditën e saj më të mirë. Suarez Navarro në çerekfinale do të ndeshet me amerikanen Keys, numri 14 në botë. Fitore gjithashtu për talenten 20-vjeçare Naomi Osaka, që mundi 2-1 bjellorusen Sabalenka, në një ndeshje e cila zgjati rreth dy orë.

Federeri eliminohet nga US Open

Roger Federer është eliminuar që në raundin e katërt të US Open nga numri 55 i renditjes botërore, John Millman. 37-vjeçari kishte si objektivi fitimin për herë të gjashtë të këtij kompeticioni, por u mposht në katër sete, 3-6, 7-5, 7-6 (9-7), 7-6 (7-3) në një ndeshje që zgjati 3 orë e 35 minuta. Kjo është hera e parë në karrierën e zviceranit që mundet nga një lojtar i renditur poshtë 50 më të mirëve në botë. Australiani Millman do të luajë tashmë në çerekfinalen e parë personale në një turne Grand Slam, kundër Novak Djokoviç të mërkurën.

Messi: Duhet ta fitojmë Ligën e Kampionëve

